European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction

SQ

# Raporti rajonal për shëndetin dhe sigurinë lidhur me drogat në Ballkanin Perëndimor

Raport rajonal

2022

European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction

# Raporti rajonal për shëndetin dhe sigurinë lidhur me drogat në Ballkanin Perëndimor

Raport rajonal

2022

## Njoftimet ligjore

Ky botim i Qendrës Evropiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat (EMCDDA) mbrohet nga e drejta e autorit. Përgatitja e këtij raporti është financuar përmes projektit EMCDDA-IPA7 (marrëveshja e kontributit të BE-së 2019/406-479), i cili financohet nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk do të intepretohen në asnjë mënyrë si qëndrim zyrtar i Bashkimit Evropian.

Luksemburg: Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian, 2023

© Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat, 2023

Riprodhimi autorizohet me kusht që të cilësohet burimi.

Citimi i rekomanduar: Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat (2023), *Raporti rajonal për shëndetin dhe sigurinë lidhur me drogat në Ballkanin Perëndimor*, Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Print** | ISBN 978-92-9497-818-9 | doi:10.2810/404536 | TD-03-22-106-SQ-C |
| **PDF** | ISBN 978-92-9497-816-5 | doi:10.2810/582773 | TD-03-22-106-SQ-N |

EMCDDA-IPA

Financuar nga Bashkimi Evropian

European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction

Praça Europa 1, Cais do Sodré, 1249-289 Lisbonë, Portugali
Tel. +351 211210200
info@emcdda.europa.eu | www.emcdda.europa.eu
twitter.com/emcdda | facebook.com/emcdda

# Përmbajtja

4 Mirënjohje

5 Hyrje

7 Përfundimet kryesore

11 Faktorët nxitës dhe lehtësues

13 Politika për drogat dhe ligji

14 Përdorimi i drogave, dëmet dhe përgjigjet

19 Ndikimi i tregjeve të drogave në Ballkanin Perëndimor

21 Roli dhe ndikimi i rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor në tregjet e drogave të BE-së

25 Kanabisi: përdorimi, prodhimi dhe furnizimi

30 Kokaina: përdorimi dhe furnizimi

34 Heroina dhe opioidet e tjera: përdorimi dhe furnizimi

37 Drogat sintetike: përdorimi, prodhimi dhe furnizimi

39 Referencat

# Mirënjohje

Ky raport bazohet në një studim të kryer nga Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GITOC) në kuadër të projektit EMCDDA-IPA7, të financuar nga BE (kodi i kontratës EMCDDA: CT.21.EU4MD.0048.2.0).

Grupi i hartimit EMCDDA: Andrew Cunningham, Frédéric Denecker, Paul Griffiths, Jane Mounteney, Andre Noor, Robert Patrancus, Roumen Sedefov, Katerina Skarupova dhe Alexander Soderholm.

Grupi i studimit GITOC: Kristina Amerhauser, Walter Kemp, Fatjona Mejdini dhe Ruggero Scaturro.

Kontribuesit për EMCDDA: Marie-Christine Ashby dhe Cécile Martel.

EMCDDA dhe ekipi i projektit IPA7 shprehin mirënjohjen e tyre për drejtuesit e observatorëve kombëtarë për drogat dhe korrespondentët kombëtarë të IPA-së te partnerët përkatës të projektit, si edhe për ekspertët e ndryshëm kombëtarë të përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të projektit IPA7 midis 2019 dhe 2022. Këto aktivitete kanë kontribuar drejtpërdrejt dhe tërthorazi në njohuritë që përbëjnë themelin për këtë raport.

# Hyrje

Ky raport ofron një pasqyrë rajonale të situatës së drogave në Ballkanin Perëndimor. Për qëllimet e kësaj analize, rajoni përfshin katër vende kandidate (Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) si dhe dy kandidatë potencialë për anëtarë të Bashkimit Evropian – Bosnjë dhe Hercegovina dhe Kosova ([1]).

EMCDDA ka punuar me Ballkanin Perëndimor që nga viti 2008 në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të bashkëpunimit teknik të financuara nga Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) i Komisionit Evropian (KE). Qëllimi i këtyre projekteve është që përfituesit të familjarizohen me politikat dhe metodat e punës të BE-së, duke i përgatitur për të raportuar tek EMCDDA në mënyrë të konsoliduar dhe të strukturuar.

Analiza e paraqitur këtu synon të adresojë disa nga boshllëqet në njohuritë për situatën rajonale lidhur me drogat, duke mbledhur informacionin në dispozicion për modelet e përdorimit të drogave dhe pasojat e tyre në kontekstin e politikave dhe përgjigjeve ndaj drogave dhe duke shikuar të dhënat mbi prodhimin, trafikimin dhe furnizimin e drogave, si edhe mbi mënyrën se si ato mund të ndikojnë në shqetësimet më të gjera lidhur me sigurinë. Duke analizuar të dhënat shëndetësore dhe të sigurisë, synimi është të sigurohet një kuptim më i ndërlidhur dhe strategjikisht i orientuar ndaj situatës së drogave sesa do të ishte nga vështrimi i këtyre fushave veçmas. Ekzistojnë kufizime serioze të të dhënave në disa fusha, megjithëse është bërë çdo përpjekje për të përdorur të gjithë informacionin aktualisht në dispozicion dhe, sipas mundësive, për të vërtetuar përfundimet e nxjerra nga burime të shumta. Për më tepër, mendimet e ekspertëve, të cilat mund të përmbajnë vështrime të dobishme, janë përdorur në këtë raport, megjithëse vlerësime të tilla nuk mund të vërtetohen në mënyrë empirike. Duke pasur parasysh këto fakte, duhet të kemi kujdes në nxjerrjen e përfundimeve nga të dhënat në dispozicion dhe prandaj i kemi kushtuar vëmendje identifikimit të boshllëqeve të rëndësishme të njohurive që meritojnë hulumtime dhe analiza të ardhshme.

Analiza e paraqitur këtu sugjeron se rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor janë bërë aktorët kryesorë si në tregun rajonal të drogave, ashtu edhe në tregun e drogave në BE. Pjesërisht kjo pasqyron pozicionin gjeografik të Ballkanit Perëndimor, i cili shtrihet në kryqëzimin e një numri rrugësh kryesore të trafikimit të drogave, siç është sidomos rruga ballkanike e heroinës, por potencialisht edhe disa rrugë të reja për droga të tjera, duke përfshirë kokainën. Ndikimi i këtyre rrjedhave të drogave në sigurinë, qeverisjen dhe shtetin e së drejtës duket të jetë i konsiderueshëm dhe ka pasoja si për rajonin, ashtu edhe për BE-në. Ekzistojnë gjithashtu prova që sugjerojnë se disa rrjete kriminale nga ky rajon kanë një prani operacionale të konsiderueshme brenda BE-së.

Megjithëse të dhënat në dispozicion tregojnë se përdorimi i përgjithshëm i drogave në rajon është i ulët sipas standardeve ndërkombëtare, me dallime të dukshme në modelet e përdorimit midis vendeve, grupmoshave dhe substancave të ndryshme. Një aspekt i rëndësishëm lidhur me të dhënat e disponueshme të përhapjes në rajon është se gatishmëria e ulët për të raportuar përdorimin e drogave dhe stigma sociale që lidhet me përdorimin e drogave mund të çojë në nën-raportim.

Ekziston një nevojë e vazhdueshme për të monitoruar dëmet që lidhen me përdorimin e opioideve dhe kokainës në këtë rajon, pasi ka disa prova që sugjerojnë se përdorimi i këtyre substancave po zhvillohet në mënyra që mund të kenë implikime të rëndësishme për të ardhmen. Në përgjithësi dhe lidhur me ofrimin e shërbimeve, të dhënat tregojnë një nevojë të përgjithshme në rajon për të rritur sigurimin e trajtimit dhe shërbimeve të tjera për njerëzit që kanë probleme me drogat. Në veçanti, përgjigjet që synojnë modelet e dëmshme të përdorimit për drogat jo-opioide duket të jenë aktualisht të pazhvilluara, megjithëse në të njëjtën kohë nevojat në këtë fushë mund të jenë në rritje.

Pasqyra rajonale e paraqitur në këtë raport fillon me një analizë të faktorëve nxitës dhe lehtësues të tregut rajonal të drogave. Kjo pasohet nga rishikimi i zhvillimeve të politikave për drogat dhe qasjeve ekzistuese ligjore dhe rregullatore. Më pas, teksti shqyrton se çfarë informacioni mund të mblidhet nga të dhënat në dispozicion për modelet e përdorimit të drogave, masat e reagimit dhe dëmet që lidhen me konsumin e drogave. Më pas, analizohen ndikimi i tregut të drogave në Ballkanin Perëndimor, si edhe roli dhe efekti i rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor në BE. Raporti përfundon me një pasqyrë rajonale të secilit prej llojeve kryesore të drogave të gjetura në zonë, duke u fokusuar në përdorimin, prodhimin dhe trafikimin e tyre.

([1]) Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

## Metodat dhe të dhënat

Monitorimi i modeleve dhe tendencave në sjelljet e fshehura dhe të stigmatizuara, si përdorimi i drogave, ose në aktivitetet kriminale, si trafikimi i drogave, është sfidues nga pikëpamja praktike dhe metodologjike. Disponueshmëria e informacionit lidhur me drogat është relativisht e kufizuar në përgjithësi në rajon, megjithëse kjo ndryshon në një farë mase nga një vend në tjetrin. Për këtë arsye, burime të shumta të dhënash përdoren për të mbështetur analizën e paraqitur këtu. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të qenësishme në të dhënat në dispozicion, duhet pasur kujdes në interpretimin e tyre, në veçanti kur vende të ndryshme krahasohen në bazë të një mase të vetme.

Autoritetet kombëtare po bëjnë përpjekje për të përmirësuar disponueshmërinë e të dhënave por ndeshen shpesh me infrastrukturën e pazhvilluar për mbikëqyrjen rutinore. Për shembull, regjistrat e trajtimit për personat që janë përdorues të drogave ekzistojnë vetëm në Malin e Zi dhe Serbi. Serbia është gjithashtu i vetmi vend që ka krijuar zyrtarisht një regjistër të veçantë të vdekshmërisë për regjistrimin e vdekjeve të lidhura me drogat, megjithëse disa të dhëna mbi këtë temë raportohen gjithashtu në mënyrë rutinore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Në disa raste, kur informacioni ekziston, të dhënat janë të vjetruara ose informacioni metodologjik nuk është i arritshëm, duke komplikuar interpretimin dhe analizën. Për shembull, ka një mungesë informacioni lidhur me metodat e përdorura për të hartuar vlerësimin e vitit 2012 për përdorimin e drogave të injektuara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në lidhje me vlerësimet e mbulimit, të cilat kanë për qëllim reduktimin e dëmeve dhe trajtimin me agonistë opioidë, ashtu siç është raportuar nga një numër organizatash ndërkombëtare. Shumë shpesh, të dhënat nga regjistrat e trajtimit dhe vdekshmërisë kanë mbulim gjeografik të kufizuar ose nuk janë ende në përputhje të plotë me protokollet EMCDDA. Duhet theksuar gjithashtu se mbledhja e shumicës së të dhënave lidhur me shëndetin që janë në dispozicion në rajon ka mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Fondi Global, për shembull, ka financuar një numër studimesh bio-bihejviorale. EMCDDA ka mbështetur edhe sondazhet e popullsisë së përgjithshme, përveç Ueb-Sondazhit Evropian mbi Drogat (EWSD) ([2]), duke bashkëfinancuar punën e Projektit Evropian të Studimit në Shkolla mbi Alkoolin dhe Drogat e Tjera (ESPAD) ([3]) në rajon.

Të dhënat mbi treguesit e lidhur me sigurinë, të tilla si shkeljet e ligjit për drogat, konfiskimet e drogave, përbërja e drogave dhe çmimet e tyre janë mbledhur nga ministritë e brendshme, ministritë e drejtësisë dhe doganat në Ballkanin Perëndimor. Janë bërë përpjekje për të mbledhur dhe parashtruar të dhëna lidhur me sigurinë pranë EMCDDA në pajtim me protokollet e saj standarde dhe kjo është një fushë në të cilën të gjitha vendet në rajon kanë bërë përparime. Megjithatë, krahasueshmëria dhe gjithëpërfshirja e përgjithshme e këtyre të dhënave mbeten problematike. Për shembull, ndërsa të gjitha vendet japin të dhëna lidhur me konfiskimet e drogave, është e qartë se ato nuk janë gjithmonë plotësisht të sakta ose të plota. Më tej, jo të gjitha vendet kanë qenë në gjendje të japin të dhëna mbi disa çështje të rëndësishme, të tilla si numri i veprave penale lidhur me drogat ose matjet e disponueshmërisë së drogave, të tilla si fuqia/pastërtia e drogave të konfiskuara dhe çmimet e vlerësuara.

Për të kapërcyer disa nga boshllëqet e informacionit, analiza e ofruar këtu bazohet gjithashtu në hulumtimin e kryer nga Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC). Ky projekt i komisionuar nga EMCDDA përfshinte pyetësorë dhe intervista gjysmë të strukturuara me më shumë se 20 palë të interesuara në Ballkanin Perëndimor. Janë organizuar gjithashtu një numër fokus-grupesh dhe është ndërmarrë rishikimi i literaturës shkencore dhe "literaturës gri" në dispozicion të botuar nga ente qeveritare dhe joqeveritare.

Të dhënat janë nxjerrë gjithashtu nga disa studime shtesë të kryera ose të mbështetura nga EMCDDA, si edhe nga informacionet që observatorët kombëtarë për drogat (NDO) i kanë ofruar EMCDDA-së. Në mungesë të një NOD, të dhënat janë siguruar nga korrespondentët kombëtarë të EMCDDA-IPA7 duke përdorur mjete rutinore dhe të konsoliduara të raportimit. Ofrohen referenca për të gjitha burimet e të dhënave dhe literaturën e përdorur në analizë. Nëse nuk specifikohet ndryshe, të dhënat cilësore të paraqitura këtu vijnë nga intervistat dhe fokus-grupet e këtij projekti.

---

([2]) Për më shumë informacion shih https://www.emcdda.europa.eu/activities/european-web-survey-on-drugs_en.

([3]) Për më shumë informacion shih https://www.emcdda.europa.eu/about/partners/espad_en.

# Përfundimet kryesore

## Faktorët nxitës dhe lehtësues

▶ Rajoni i Ballkanit Perëndimor shtrihet në kryqëzimin e disa rrugëve kryesore të trafikimit të drogave. Kanabisi, kokaina, heroina, drogat sintetike dhe prekursorët kontrabandohen brenda dhe jashtë rajonit (shih Figurën 1).

▶ Siç duket, globalizimi dhe infrastruktura e udhëtimit dhe transportit që lidhet me këtë shfrytëzohet gjithnjë e më shumë nga rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor. Kjo është më e dukshme në rastin e kokainës, ku duket se disa rrjete tani janë të përfshira në të gjithë zinxhirin e furnizimit, nga prodhimi në Amerikën Jugore dhe importi në BE, deri në shpërndarjen me shumicë dhe lokale. Duket se kërkesa e madhe për drogat në BE dhe fitimet e larta lidhur me furnizimin e drogave janë ndër nxitësit kryesorë të këtyre zhvillimeve dhe se kanë përforcuar rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor në mënyrë që të marrin pjesë në shumë aspekte të zinxhirit të furnizimit të drogave të paligjshme.

▶ Rrjetet kriminale kanë përvetësuar komunikimin e koduar dhe mund të përdorin tregjet online dhe

FIGURA 1

**Rrugët kryesore për trafikimin e drogave në Ballkanin Perëndimor**




Rrugët hyrëse, dalëse dhe të trafikimit të brendshëm të identifikuara në Ballkanin Perëndimor për kanabisin bimor, kokainën, heroinën dhe drogat sintetike.
Burimet: EMCDDA dhe GI-TOC.

kriptomonedhat për t'iu shmangur masave të zbatimit të ligjit. Kjo sugjeron se tregu i drogave në rajon po bëhet më i aftësuar nga pikëpamja dixhitale dhe se teknologjia dhe novacionet operacionale të ndërlidhura po ofrojnë përfitime për rrjetet kriminale të përfshira në prodhimin dhe trafikimin e drogave, si edhe në pastrimin e parave.

▶ Mjedisi i brendshëm në rajon, veçanërisht në lidhje me korrupsionin, vepron gjithashtu si një lehtësues për përforcimin dhe zgjerimin e rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor.

## Politika dhe ligji për drogat

▶ Dokumente për politikat lidhur me drogat, me të cilat ndiqen kryesisht struktura dhe përmbajtja e politikave ekzistuese të BE-së dhe planet e veprimit janë miratuar nga Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

▶ Vetëm Maqedonia e Veriut dhe Serbia duket se kanë tani për tani një observator funksional për drogat; dhe vetëm Serbia ka një sistem kombëtar aktiv të paralajmërimit të hershëm.

▶ Kapaciteti për monitorimin e drogave në rajon është i pazhvilluar. Kjo është e vërtetë sidomos për shumë tema të lidhura me shëndetin, por treguesit në aspektin e furnizimit janë gjithashtu të papërshtatshëm. Për të siguruar që kjo situatë të përmirësohet, palët e interesuara duhet të pranojnë vlerën e mbledhjes së informacionit, të mbështetjes politike për aktivitetet e mbledhjes së të dhënave dhe të investimeve të qëndrueshme në përpjekjet për mbledhjen e të dhënave.

▶ Megjithëse përdorimi i drogave nuk është veçanërisht i kriminalizuar në rajon, posedimi i drogave është një vepër penale në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovë dhe Serbi, ndërkohë që përbën një kundërvajtje administrative në Shqipëri, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe pjesën tjetër të Bosnjës dhe Hercegovinës.

## Përdorimi, dëmet dhe përgjigjet

▶ Përdorimi i drogave në rajon është i ulët në përgjithësi sipas standardeve ndërkombëtare, megjithëse një aspekt shumë i rëndësishëm këtu është se ekzistojnë dallime nga një vend në tjetrin lidhur me modelet e përdorimit dhe substancat e përfshira. Përdorimi i drogave raportohet më shumë te burrat sesa gratë dhe ky hendek është i madh në disa vende. Siç është theksuar më parë, kufizimet e të dhënave pengojnë gjithashtu prodhimin e vlerësimeve të sakta mbi përhapjen e drogave. Të dhënat e përhapjes që ekzistojnë për rajonin mund të nënvlerësojnë numrat përkatës, për shkak të mungesës së gatishmërisë për të raportuar përdorimin e drogave dhe stigmës sociale lidhur me përdorimin e drogave.

▶ Modelet me rrezik të lartë dhe veçanërisht të dëmshme për përdorimin e drogave në rajon duket se janë të lidhura kryesisht me përdorimin e heroinës dhe opioideve të tjera, të tilla si buprenorfina dhe metadoni. Megjithatë, në disa vende kokaina pluhur dhe kokaina krak kanë qenë të lidhura me përdorimin e drogave të injektuara dhe vdekjet si pasojë e përdorimit të drogave.

▶ Nivelet e infeksionit me HIV në radhët e personave që injektojnë droga në rajon janë përgjithësisht të ulëta, ndërsa përhapja e infeksionit të hepatitit C varion në mënyrë të konsiderueshme nga një vend në tjetrin dhe nivelet janë përgjithësisht të krahasueshme me ato të vërejtura në BE. Megjithatë, disa nga të dhënat në këtë fushë janë mjaft të vjetra dhe ka nevojë për studime të mëtejshme, me qëllim për të kuptuar nëse ato janë akoma aktuale për situatën e tanishme.

▶ Shumica e vdekjeve të lidhura me drogat të raportuara në rajon ishin të lidhura me përdorimin e opioideve, me saktë heroinë ose metadon, nganjëherë në kombinim me benzodiazepinat. Numri i vdekjeve, ku është konstatuar përdorimi i kokainës, është relativisht i lartë në disa vende. Megjithatë, një paralajmërim i rëndësishëm këtu është se paqëndrueshmëria e të dhënave e bën të vështirë të komentohet në mënyrë të besueshme për nivelet e vdekjeve të lidhura me drogat, si dhe ekziston një pasiguri e konsiderueshme në këtë fushë.

▶ Shërbimet për reduktimin e dëmeve operojnë në të gjitha vendet e rajonit. Megjithatë, ndërhyrjet e bëra për reduktimin e dëmeve duket se janë përgjithësisht të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e vendeve dhe varen shpesh nga financimi ndërkombëtar. Në shumicën e vendeve, organizatat joqeveritare luajnë një rol të rëndësishëm në reduktimin e dëmeve dhe ofrimin e terapisë me agonistë opioidë.

▶ Trajtimi në dispozicion është i konfiguruar kryesisht për të përmbushur nevojat e njerëzve që kanë probleme me opioidët. Numri i njerëzve që fillojnë një trajtim të specializuar për probleme me substanca të tjera është shumë i ulët në përgjithësi. Mendohet se kjo pasqyron, së paku pjesërisht, mungesën e disponueshmërisë së shërbimit.

## Ndikimi i tregjeve të drogave dhe rrjeteve kriminale në Ballkanin Perëndimor dhe BE

▶ Rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor kanë një ndikim të rëndësishëm në sigurinë, qeverisjen dhe shtetin e së drejtës në rajon. Disa nga këto rrjete duket se janë aktive edhe në BE, duke marrë pjesë në prodhimin, trafikimin dhe shpërndarjen e drogave.

▶ Një nga kërcënimet më shqetësuese për sigurinë që kjo situatë gjeneron është dhuna që lidhet me konkurrencën për tregjet e drogave dhe kontrollin e rrugëve të trafikimit. Kjo ndikon në nivelet e krimeve të dhunshme si brenda rajonit ashtu edhe në BE. Për shembull, një numër vrasjesh në BE janë të lidhura me rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor të përfshira në tregtinë e kokainës.

▶ Rrjetet kriminale të organizuara nga Ballkani Perëndimor duket të jenë polikriminale, domethënë ato janë të angazhuara kryesisht në trafikun e drogave, por marrin pjesë gjithashtu në aktivitete të tjera të paligjshme, duke përfshirë kontrabandën e armëve, trafikimin njerëzor dhe pastrimin e parave.

▶ Disa nga këto rrjete duket se kanë zgjeruar praninë e tyre operacionale në tregun e drogave të BE-së. Kjo është e lidhur me një përfshirje më të madhe në zinxhirin e furnizimit të kokainës, i cili përfshin tashmë aktivitete në Amerikën Latine, por gjithashtu duket të jetë i lidhur me një përfshirje në prodhimin e kanabisit në disa vende të BE-së.

▶ Duket se disa rrjete kriminale nga Ballkani Perëndimor kanë përvetësuar një model të ri biznesi, të përfshirjes së drejtpërdrejtë në prodhimin e kanabisit brenda BE-së. Prania e tyre është vërejtur në disa vende të BE-së, kryesisht lidhur me prodhimin në mjedise të brendshme.

▶ Ka të dhëna se një pjesë e kanabisit të prodhuar në Ballkanin Perëndimor trafikohet në Turqi, ku shkëmbehet me heroinë.

## Kanabisi

▶ Kanabisi është droga e paligjshme më e konsumuar në rajon dhe përdorimi i tij duket se është rritur në vitet e fundit, veçanërisht midis të rinjve.

▶ Modelet e kultivimit të kanabisit në rajon po ndryshojnë dhe diversifikohen. Në Shqipëri, kultivimi i kanabisit në mjedise të jashtme është reduktuar ndjeshëm në krahasim me më parë, ndërsa në shumë vende në rajon janë regjistruar mjedise të brendshme për kultivimin e kanabisit në shkallë të gjerë.

▶ Ekzistojnë shqetësime se një pjesë e kanabisit të prodhuar ligjërisht për qëllime mjekësore mund të devijohet në tregun e paligjshëm. Prodhimi i kanabisit për përdorim mjekësor është legalizuar në Maqedoninë e Veriut, ndërsa një masë e ngjashme po diskutohet në Shqipëri.

## Kokaina

▶ Në bazë të të dhënave të disponueshme të sondazhit të përgjithshëm të popullsisë, kokaina është droga e dytë më e zakonshme e raportuar, pas kanabisit, në radhët e të rriturve në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, disa nga këto sondazhe janë të vjetruara dhe tani ka forma të tjera të përdorimit të drogave, sidomos forma më të stigmatizuara, si edhe substanca të reja, duke përfshirë ato të lidhura me opioidet, të cilat mund të nënvlerësohen nga këto metoda sondazhi. Injektimi i kokainës, i vetëm ose në kombinim me heroinën, dhe përdorimi i kokainës krak janë raportuar gjithashtu në disa vende.

▶ Konfiskimet e drogave gjatë dy viteve të fundit tregojnë se rëndësia e porteve detare të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në Shqipëri dhe Malin e Zi, është rritur në mënyrë të dukshme, megjithëse sasitë e konfiskuara janë akoma të ulëta në krahasim me ato të konfiskuara në disa porte të mëdha të BE-së.

▶ Rrjetet kriminale nga rajoni i Ballkanit Perëndimor apo me lidhje të forta me të janë shfaqur si lojtarë të mëdhenj në tregun e kokainës në BE dhe duket se janë të përfshira në lëvizjen e drogave nga Amerika Latine direkt në portet evropiane. Sipas raporteve ekzistuese, ata janë tashmë të pranishëm në vendet kyçe për eksportin dhe importin e kokainës si në Amerikën Latine ashtu edhe në BE.

## Heroina dhe opioidet e tjera

▶ Heroina është opioidi më i përdorur në gjithë rajonin, megjithëse metadoni përdoret më shpesh në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Në disa vende është raportuar një treg i paligjshëm për metadonin dhe buprenorfinën e devijuar.

▶ Konfiskimet rajonale të heroinës duket se janë të qëndrueshme në përgjithësi. Pjesa më e madhe e heroinës duket se kalon nëpër rajon gjatë transportit drejt BE-së në rrugë tokësore apo detare.

- Vitet e fundit, nuk janë shënuar ndryshime të rëndësishme në trafikun e heroinës. Megjithatë, fenomeni i shkëmbimit të heroinës me kanabis bimor të prodhuar në nivel lokal është një çështje që ka ngritur shqetësime dhe kërkon hetime dhe monitorime të mëtejshme.

- Disa nga anhidridet acetike (kimikati prekursor për prodhimin e heroinës) që devijohen nga furnizimi i ligjshëm në BE, kalojnë nëpër rajonin e Ballkanit Perëndimor për t'u transportuar drejt zonave të prodhimit të heroinës.

## Drogat sintetike

- Amfetamina është droga sintetike më e konfiskuar dhe e konsumuar në rajon, megjithëse aktualisht në nivel të ngjashëm është edhe përdorimi i MDMA-së (ekstazit) në disa vende.

- Tregjet e drogave sintetike në rajonin e Ballkanit Perëndimor duket se janë shumë dinamike dhe mendohet se ato furnizohen kryesisht nga prodhimi i kryer në BE. Megjithatë, është raportuar edhe prodhimi vendor dhe ky zhvillim mund të përbëjë një kërcënim të rëndësishëm në të ardhmen.

- Me gjasë, prekursorët për prodhimin e drogave sintetike kalojnë nëpër rajon gjatë transportit drejt BE-së.

- Rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor duket se janë më pak të përfshira në trafikun e drogave sintetike, në krahasim me droga të tjera.

## Faktorët nxitës dhe lehtësues

Ka disa faktorë nxitës dhe lehtësues kryesorë për tregun rajonal të drogave në Ballkanin Perëndimor. Ky treg është kompleks, shumë i adaptueshëm dhe novator, në sajë të faktorëve të tillë si infrastruktura në zhvillimin e transportit, vendndodhja strategjike e rajonit, globalizimi dhe përparimet teknologjike. Këta faktorë kanë mundësuar që prodhimi dhe trafikimi i drogave të integrohet gjithnjë e më shumë në nivel rajonal dhe global. Për më tepër, përdorimi i internetit dhe efekti i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në të gjitha segmentet e shoqërisë kanë ofruar mundësi të reja për krimin e organizuar në një numër fushash thelbësore, duke përfshirë logjistikën, bashkëpunimin kriminal dhe rrjedhat financiare. Korrupsioni është bërë gjithashtu një mundësues i rrjeteve kriminale, çka dëmton qeverisjen dhe shtetin e së drejtës.

### Vendndodhja strategjike gjeografike dhe globalizimi

Një nga faktorët kryesorë nxitës të trafikimit të drogave në Ballkanin Perëndimor duket se është vendndodhja e këtij të fundit midis vendeve të përfshira në prodhimin dhe furnizimin e drogave dhe vendeve me kërkesë të lartë për droga, veçanërisht në BE. Si një qendër e madhe për transferimin e mallrave, duke përfshirë trafikimin e kanabisit, heroinës dhe, kohët e fundit, kokainës, rajoni është i lidhur me tregjet e BE-së përmes autostradave, porteve detare, hekurudhave dhe aeroporteve. Investimet e mëdha nga BE dhe Kina (si pjesë e Iniciativës "Një Brez Një Rrugë"), si edhe nga Turqia, Rusia dhe disa shtete të Gjirit (të tilla si Emiratet e Bashkuara Arabe) po përmirësojnë infrastrukturën e rajonit. Megjithatë, ky zhvillim duket se nuk është shoqëruar me një rritje përkatëse të investimeve në sigurinë dhe menaxhimin e kufijve (GI-TOC, 2022).

Rajoni është i lidhur mirë gjithashtu me tregjet financiare ndërkombëtare, megjithatë raportohet se nuk plotëson standardet evropiane dhe ndërkombëtare në disa aspekte të rregullimit të integritetit të tregjeve të tij financiare, duke e bërë të prekshëm ndaj rrjedhave të paligjshme financiare dhe pastrimit të parave (Cartwright dhe Amerhauser, 2022; Reitano dhe Amerhauser, 2020).

Globalizimi dhe rritja e fleksibilitetit lidhur me udhëtimet dhe zhvendosjet duket të shfrytëzohen edhe nga rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor. Disa nga këto rrjete duket se janë të përfshira në gjithë zinxhirin e furnizimit për tregtinë e kokainës, nga fushat e kokës në Amerikën Jugore deri në shpërndarjen e kokainës në rrugët e qyteteve evropiane të mëdha. Duket se këto rrjete bashkëpunojnë shpesh në mënyrë të ngushtë edhe me rrjete kriminale të tjera që veprojnë në pika të ndryshme të zinxhirit të furnizimit, siç janë për shembull grupet lokale të përfshira në prodhimin ose shpërndarjen e drogave. Lidhjet me rrjete kriminale ndërkombëtare aktive të tjera janë vërejtur gjithashtu, për shembull midis grupeve shqipfolëse dhe rrjeteve kriminale italiane. Rrjetet e tilla duket se shfrytëzojnë ose rekrutojnë njerëz edhe nga diasporat në BE me qëllim për të zhvilluar më tej aktivitetet e tyre kriminale.

### Kërkesa, furnizimi dhe fitimet

Një nxitës tjetër për prodhimin dhe trafikimin e drogave në rajonin e Ballkanit Perëndimor duket të jetë kërkesa për kanabis brenda rajonit si edhe në BE dhe Turqi. Kërkesa e madhe për kanabis bimor në BE, për shembull, mund të ketë kontribuuar që disa rrjete kriminale të Ballkanit Perëndimor të zhvendosen në vendet e BE-së në mënyrë që të jenë më afër këtyre tregjeve të konsumit, ku duket se ato janë gjithnjë e më të përfshirë në organizimin dhe funksionimin e plantacioneve të kanabisit.

Thuhet se rritja e prodhimit të kokainës në Amerikën Jugore ka ofruar mundësi të reja për rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të kontrabandojnë sasi të mëdha kokaine drejtpërsëdrejti si në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe në Evropë. Eliminimi i ndërmjetësve duket se u ka mundësuar këtyre rrjeteve të grumbullojnë fitime më të larta (shih gjithashtu pjesën Kokaina: përdorimi dhe furnizimi).

Ndërsa grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë bërë gjithnjë e më të lëvizshme, të afta dhe të suksesshme, pasuria dhe fuqia që kjo situatë sjell ka krijuar një profil tërheqës që disa njerëz aspirojnë të imitojnë. Si rezultat, disa të rinj (kryesisht burra të rinj) nga komunitetet e margjinalizuara janë të tunduar të integrohen në këto grupe. Kjo është mbështetur nganjëherë nga muzika dhe përmbajtja e mediave sociale, të cilat reklamojnë aktivitetet e disa grupeve, shpesh të identifikuara mbi linja etnike.

### Zhvillimet teknologjike që lehtësojnë aktivitetet kriminale

Është vërejtur që rrjetet kriminale nga rajoni i Ballkanit Perëndimor përqafojnë teknologjinë më të fundit për të përmirësuar efikasitetin e vet lidhur me prodhimin dhe

trafikimin e drogave, si edhe me pastrimin e parave, duke përfshirë pajisje komplekse për kultivimin në mjedise të brendshme, përdorimin e dronëve, komunikimet e koduara (Jeremic e të tj., 2022; Slobodna Bosna, 2021) dhe kriptovalutat (Grauer dhe Jardine, 2022). Rrjetet kriminale të sofistikuara gjithashtu duket se kanë përvetësuar përdorimin e komunikimeve të koduara (Europol, 2021b; Politiko, 2022b). Me zhvillimet teknologjike të reja, ekspertët kanë identifikuar rrezikun e përdorimit gjithnjë e më shumë të dronëve për transportin e drogës në të ardhmen. Kjo përbën një kërcënim të mundshëm në të ardhmen për sa u përket drogave që trafikohen nga Ballkani Perëndimor në vendet fqinje të BE-së.

Megjithëse kjo nuk mund të vërtetohet në mënyrë empirike, raportohet se njerëzit që përdorin droga në Ballkanin Perëndimor po përdorin gjithnjë e më shumë teknologjinë dixhitale për të lehtësuar blerjen e drogave. Kjo mund të mundësoj që rrjetet kriminale të arrijnë një numër më të madh klientësh potencialë dhe të krijojnë sfida më të mëdha për zbatimin e ligjit. Raportohet se lloje të ndryshme drogash janë në dispozicion përmes platformave online në rajon, duke përfshirë darknet-in, por edhe përmes aplikacioneve dhe platformave të mediave sociale (Biznis & Finansije, 2020). Për shembull, njerëzit mund të porosisin kanabis dhe MDMA (ekstazi) drejtpërdrejt përmes Instagramit (CDM, 2019). Ndoshta tregu i drogave në internet është bërë edhe më i rëndësishëm si burim furnizimi gjatë pandemisë COVID-19, kur kufizimet e lëvizjes kanë penguar njerëzit që të përdorin droga të prokuruara nga ndërveprimi i drejtpërdrejtë me tregtarët e drogave (EMCDDA, 2021a).

Në bazë të një studimi mbi transaksionet me kriptovaluta në blockchain, duket se shitësit e drogave nga Ballkani Perëndimor janë të pranishëm në tregjet e darknet-it, por jo në të njëjtën shkallë si shitësit me bazë në BE (Grauer dhe Jardine, 2022). Përdorimi i kriptovalutave rregullohet në disa prej vendeve në rajon. Për shembull, Maqedonia e Veriut ka ndaluar përdorimin e kriptovalutave (Chakraborty, 2021), ndërsa Kosova ka ndërmarrë hapa ligjorë për të ndaluar prodhimin e kriptovalutave për shkak të konsumimit intensiv të energjisë lidhur me këto aktivitete (Bami, 2022). Në Bosnjë dhe Hercegovinë, aktualisht nuk ka rregullore për përdorimin e kriptovalutave. Megjithatë, Banka Qendrore ka deklaruar se vetëm monedha zyrtare mund të përdoret për kryerjen e pagesave (Vijesti, 2018). Kriptovalutat janë të parregulluara në Malin e Zi (Veljović dhe Vučinić, 2022), ndërsa Shqipëria dhe Serbia kanë rregulluar përdorimin e tyre (Kalo & Associates, 2020; Gurcan Partners, 2022).

## Mjedisi i brendshëm

Korrupsioni duket të jetë një nga mundësuesit e prodhimit dhe trafikimit të drogave në rajon (Francë24, 2019; GI-TOC, 2021b). Ndërsa vlerësimi i shkallës së problemit është i vështirë, ka pasur disa raste të zyrtarëve të arrestuar për lehtësimin apo pjesëmarrjen në trafikun e drogës dhe janë vërejtur lidhje midis zyrtarëve të shtetit dhe grupeve kriminale. Për shembull, në mars 2021, është raportuar se disa oficerë policie nga Bosnja dhe Hercegovina po punonin me kohë të pjesshme si truproja personale për një kriminel të njohur. Megjithëse oficerët janë shkarkuar nga policia, thuhet se ata vazhdojnë të punojnë për këtë person (Avdić, 2021). Sipas raporteve vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Serbi janë ngritur 44 kallëzime penale kundër policëve për vepra penale të lidhura me drogat midis viteve 2017 dhe 2020 (Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, 2018, 2019, 2020b, 2021).

Indeksi Global i Krimit të Organizuar tregon se aktorët kriminalë të infiltruar në strukturat shtetërore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e ekonomive të paligjshme dhe në pengimin e rezistencës së shtetit ndaj krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Sipas Indeksit, disa vende në Ballkanin Perëndimor (të tilla si Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia) kanë nga nivelet më të larta në Evropë sa u përket aktorëve kriminalë të infiltruar në strukturat shtetërore (GI-TOC, 2021b). Indeksi tregon gjithashtu se grupet me stil mafioz mund të përdorin korrupsionin për të gëzuar mbrojtje në disa vende të rajonit. Kushte të tilla mund të krijojnë një mjedis që mundëson trafikimin e drogës dhe lloje të tjera të krimit të organizuar (GI-TOC, 2021b).

Një nxitës tjetër për t'u përfshirë në tregjet e drogave në rajon mund të jetë mungesa e mundësive të ligjshme të punësimit, veçanërisht te komunitetet e margjinalizuara. Kjo mund të shtyjë disa njerëz drejt trafikimit dhe kultivimit të drogave dhe duket se kjo prirje mund të jetë përkeqësuar nga COVID-19.

## Politika për drogat dhe ligji

Dokumentet e politikave për drogat synojnë të pasqyrojnë përparësitë e qeverive kombëtare në trajtimin e çështjeve të lidhura me drogat. Dokumente specifike për politikat lidhur me drogat, të cilat ndjekin kryesisht strukturën dhe përmbajtjen e politikave dhe planeve ekzistuese të veprimit të BE-së – me fokus në reduktimin e kërkesës për droga, reduktimin e furnizimit me droga dhe çështjet ndërsektoriale, siç janë monitorimi dhe koordinimi – janë miratuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (shih gjithashtu seksionin Sistemet kombëtare për monitorimin e drogave). Në Shqipëri, dokumentet e politikave përkatëse dhe aktive lidhur me drogat mbulojnë vetëm çështjet e lidhura me krimin e organizuar. Strategjitë për drogat në Malin e Zi dhe Serbi kanë skaduar teknikisht, por vazhdojnë të udhëheqin veprimet e aktorëve kombëtarë. Të gjitha vendet në rajon që kanë strategji specifike për drogat e njohin nevojën për shërbime që synojnë reduktimin e dëmeve. Shqipëria nuk ka një strategji për drogat, por thekson nevojën për të reduktuar dëmet specifike lidhur me HIV në Planin e saj Kombëtar të Veprimit për HIV/AIDS 2020-2025.

Shkeljet e ligjit për drogat përcaktohen zakonisht në Kodet Penale të secilit prej shteteve të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut adresojnë posedimin dhe përdorimin e drogave nëpërmjet ligjeve të specializuara për kontrollin e substancave narkotike ose parandalimin e përdorimit të drogave. Përdorimi i drogave nuk është i ndaluar, përveç se në hapësirat publike. Veprat penale lidhur me posedimin dhe përdorimin e drogave ndryshojnë shumë midis vendeve në rajon. Posedimi i sasive të vogla të drogave për përdorim personal është i përjashtuar nga dënimi në Shqipëri, ndërsa trajtohet si një kundërvajtje administrative në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut dhe si një vepër penale në Kosovë dhe Serbi. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, veprat penale të lidhura me përdorimin e drogave dhe posedimin e sasive të vogla të drogave rregullohen nga njësitë federale dhe qarku Brčko. Në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, posedimi për përdorim personal është një vepër penale, ndërsa në Republikën Sërpska dhe qarkun Brčko konsiderohet një kundërvajtje.

Në Maqedoninë e Veriut, ku përdorimi mjekësor i kanabisit ka qenë i ligjshëm që nga viti 2016, Ligji për Kontrollin e Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope është përditësuar kohën e fundit, duke siguruar një bazë ligjore për prodhimin e kanabisit për qëllime mjekësore. Megjithatë, ka shqetësime se prodhimi i kanabisit mjekësor në Maqedoninë e Veriut është vënë në shënjestër nga rrjetet kriminale dhe raportohet se sasi të mëdha të kanabisit mjekësor mund të jenë vjedhur nga grupet kriminale dhe se, ndonjëherë, në kuadër të kultivimit për qëllime mjekësore bëhet edhe kultivim i paligjshëm (shih pjesën Kanabisi: përdorimi, prodhimi dhe furnizimi). Diskutimet lidhur me përdorimin mjekësor të kanabisit janë aktualisht në vazhdim në Shqipëri, ku në një sondazh i porositur nga qeveria në vitin 2022, me pjesëmarrjen e më shumë se 500 000 qytetarëve, tregon se mbi 60% e të anketuarve favorizojnë legalizimin e përdorimit mjekësor të kanabisit (Kote, 2022b).

### Sistemet kombëtare për monitorimin e drogave

Megjithëse dokumentet e politikave dhe strategjitë kombëtare për drogat në Ballkanin Perëndimor parashikojnë sisteme funksionale për monitorimin e drogës, ose së paku përmirësime në disa nga komponentët e tyre, vetëm Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë tani për tani një observator funksional për drogat; dhe vetëm Serbia ka një sistem kombëtar funksional të paralajmërimit të hershëm. Në përgjithësi, ka boshllëqe thelbësore në monitorimin e drogave, si edhe në përgjigjet në dispozicion për të adresuar problemet e drogave (shih gjithashtu pjesën "Përgjigjet lidhur me përdorimin e drogave dhe dëmet"). Një qasje më sistematike dhe e koordinuar për ndërtimin e sistemeve kombëtare të informacionit për drogat, duke përfshirë harmonizimin me standardet e BE-së, është akoma e nevojshme në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

# Përdorimi i drogave, dëmet dhe përgjigjet

## Përdorimi i drogave në Ballkanin Perëndimor

Vlerësimi i saktë i tendencave të përhapjes së drogave në rajon pengohet nga mungesa e studimeve të mira dhe aktuale. Megjithatë, në bazë të sondazheve të përgjithshme të popullsisë në dispozicion dhe sondazheve në radhët e fëmijëve të moshës shkollore, nivelet e njerëzve që raportojnë ndonjë përdorim drogash në Ballkanin Perëndimor janë përgjithësisht të ulëta kur krahasohen me tregues të ngjashëm nga shtetet anëtare të BE-së. Sidoqoftë, ka dallime midis vendeve lidhur me modelet e përdorimit të substancave dhe grupmoshat. Për shembull, rezultatet e sondazhit mbi përdorimin e kanabisit janë përgjithësisht të krahasueshme me ato të vendeve të BE-së që konsiderohen si vende me përhapje të ulët, disa prej të cilave kufizohen me Ballkanin Perëndimor (të tilla si Bullgaria, Rumania dhe Greqia). Në krahasim, raportohet se përdorimi i vlerësuar i kokainës midis të rinjve (të moshës 15-34 vjeç) ishte shumë më i lartë në Shqipëri në vitin 2014 dhe në Maqedoninë e Veriut në vitin 2017 sesa mesatarja e BE-së në vitin 2020 (EMCDDA, 2022). Disa nga të dhënat e sondazheve në dispozicion janë mjaft të vjetra dhe, në përgjithësi, ndikimi i devijimeve lidhur me përgjigjen dhe mospërgjigjen duhet të merret parasysh gjithmonë kur shqyrtohen gjetjet nga sondazhet dhe kur bëhen krahasime midis vendeve. Fakti që tendencat në përdorimin e drogave mund të ndryshojnë mjaft shpejt nënvizon më tej nevojën për studime më aktuale, të kryera duke përdorur metoda të konsoliduara, me qëllim për të siguruar një kuptim më të mirë të zhvillimeve në modelet e konsumit të drogave brenda rajonit.

Në tërësi, të dhënat sugjerojnë se kanabisi mbetet droga e paligjshme më e përdorur në rajon, pasuar nga kokaina. Praktikuesit kanë vërejtur se të dyja këto droga përdoren më gjerësisht, edhe pse, siç është theksuar më parë, analizat e bazuara në tendenca empirikisht të dokumentuara nuk janë aktualisht të mundshme për shkak të mungesës së të dhënave në dispozicion. Përdorimi i kanabisit shënohet kryesisht midis të rinjve, ndërsa duket se kokaina përdoret më shpesh nga klasa e mesme urbane, si edhe në resorte turistike anembanë rajonit. Përveç kësaj, janë raportuar vdekje të lidhura me kokainën në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa injektimi i kokainës dhe përdorimi i kokainës krak te grupet më të margjinalizuara është shënuar në disa vende.

Problemet afatgjata, kronike dhe me rrezik të lartë lidhur me drogat në rajon duket se janë të lidhura kryesisht me heroinën dhe opioide të tjera të tilla si buprenorfina dhe metadoni, megjithëse në disa vende, siç kemi përmendur më parë, kokaina dhe kokaina krak janë të njohura si substanca që përdoren nga disa grupe të cenueshme njerëzish. Në përgjithësi, mungojnë vlerësime lidhur me numrin e njerëzve që përdorin opioide ose injektojnë droga. Për më tepër, të dhënat mbi trajtimin, të cilat mund të ofrojnë një dritare tjetër lidhur me këto sjellje, kanë një natyrë paraprake dhe janë aktualisht të disponueshme vetëm për vitet 2019 dhe 2020. Duke marrë parasysh se pandemia COVID-19 ka ndikuar në kërkimin dhe ofrimin e trajtimit në vitin 2020, kjo parandalon çdo vlerësim të tendencave themelore.

Informacioni në dispozicion për modelet e përdorimit të drogave sintetike sugjeron se situata në gjithë rajonin është mjaft heterogjene. Për shembull, vlerësimet e përdorimit të MDMA-së (ekstazit) në Malin e Zi dhe të amfetaminave në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut në radhët e të rriturve janë më të larta sesa mesatarja e BE-së, por ky nuk është rasti në vende të tjera. Në mënyrë të ngjashme, të dhënat e raportuara nga Projekti Evropian i Studimit në Shkolla mbi Alkoolin dhe Drogat e Tjera (ESPAD) tregojnë se nivelet e përdorimit të amfetaminave në radhët e adoleshentëve në Malin e Zi dhe Serbi janë të ngjashme ose më të larta sesa mesatarja e BE-së. Të dhënat në dispozicion sugjerojnë gjithashtu se përdorimi i substancave psikoaktive të reja (SPP) nuk është i zakonshëm, megjithëse një aspekt shumë i rëndësishëm që duhet ta kemi parasysh këtu është se ky përfundim bazohet në të dhëna të kufizuara. Për më tepër, opinioni i ekspertëve tregon se përdorimi i kanabinoidëve sintetikë mund të jetë në rritje në Serbi. Një problem i përgjithshëm është se ekspertët e intervistuar për këtë studim kanë shënuar një numër tendencash të reja dhe potencialisht të rëndësishme lidhur me përdorimin e drogave, të cilat nuk mund të vërtetoheshin në mënyrë empirike për shkak të mungesës së studimeve. Prandaj, këto raporte cilësore duhen ndjekur në hulumtimet ose monitorimet sasiore të ardhshme.

Një problem potencial për vlerësimin e përdorimit të drogave në rajon është hezitimi për të pranuar sjellje shumë të stigmatizuara dhe përgjithësisht të pamiratuara, duke shkaktuar devijime lidhur me përgjigjen ose mospërgjigjen (shih fushën Stigmat dhe qëndrimet ndaj përdorimit të drogave). Kjo çështje nuk është unike për Ballkanin Perëndimor, por mund të ketë implikime të rëndësishme për interpretimin e vlerësimeve aktuale dhe të ardhshme të përhapjes, si edhe për hartimin e studimeve të ardhshme.

Normat e nënraportimit mund të ndryshojnë gjithashtu sipas ndryshoreve të rëndësishme demografike siç është gjinia. Në përgjithësi, duket se burrat janë më të gatshëm se

### Stigmat dhe qëndrimet ndaj përdorimit të drogave

Stigmat sociale lidhur me përdorimin e drogave dhe e drejtuar kundër atyre që përdorin droga duket se janë të zakonshme në Ballkanin Perëndimor. Në sondazhet kombëtare përfaqësuese të popullsisë së rritur, të kryera midis viteve 2014 dhe 2018, shumica e të anketuarve kanë shprehur mosmiratim për përdorimin e drogave dhe kishin një perceptim të përhapur se njerëzit me çrregullime lidhur me përdorimin e substancave janë kriminelë. Megjithatë, mendimi i ekspertëve dhe disa të dhëna sugjerojnë se këto qëndrime janë duke ndryshuar, së paku lidhur me përdorimin e drogave rekreative. Ka shenja se kanabisi dhe disa forma të përdorimit të kokainës po bëhen më të pranueshme nga shoqëria.

Megjithatë, nivelet e stigmës sociale duket se mbeten të larta lidhur me përdorimin e drogave te grupet e margjinalizuara ose të përjashtuara, njerëzit që kanë probleme dhe kërkojnë ndihmë dhe ata që përdorin opioide ose injektojnë droga.

Opinioni i ekspertëve përshkruan gjithashtu se si përdorimi i drogave reklamohet në mediat sociale dhe nga njerëzit e famshëm, duke u asociuar shpesh me dhunën dhe një mënyrë "të pasur" jetese. Profilet e mediave sociale të disa kriminelëve të mirënjohur ose njerëzve të lidhur ngushtë me rrjetet kriminale në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë tërhequr më shumë se gjysmë milioni ndjekës.

gratë për të raportuar përdorimin e drogave në sondazhet e kryera në Ballkanin Perëndimor. Ndërsa në disa vende, të tilla si Bosnjë dhe Hercegovina, dallimet në nivelet e raportimit duket se janë akute, në vende të tjera në rajon (për shembull në Malin e Zi dhe Serbi) raportimi nga gratë për përhapjen e përdorimit të drogave është shumë pak më i ulët sesa raportimi nga burrat. Gjithashtu, duket se gratë regjistrohen rrallë si pjesëmarrës në trajtim ose si klientë të shërbimeve për reduktimin e dëmeve – çka mund të lidhet me stigmën dhe mungesën e shërbimeve specifike për gratë, duke mos pasqyruar nevojën e përgjithshme për shërbime nga gratë që përdorin droga. Për shembull, edhe në Malin e Zi, ku sondazhet tregojnë se dallimet në përdorimin e drogave midis burrave dhe grave janë më pak të dukshme në krahasim me vendet e tjera në rajon, asnjë grua nuk ka marrë pjesë në një sondazh bio-bihejvioral ndër njerëzit që injektojnë droga, të cilët janë rekrutuar përmes programeve lokale për reduktimin e dëmeve. Ndërsa dallimet gjinore mund të ekzistojnë dhe është pothuajse e sigurt se ekzistojnë, lidhur me modelet e përdorimit të drogave, këto dallime mund të theksohen nga problemet e nënraportimit. Kështu, në shembullin e fundit duket se stigma mund të veprojë si një pengesë për gratë si në qasjen në shërbime, ashtu edhe në angazhimin në studime hulumtuese dhe prandaj nuk mund të supozohet se rezultatet nënkuptojnë domosdo shmërishtse nuk ka ose ka shumë pak gra që injektojnë droga në Malin e Zi.

## Disponueshmëria e perceptuar e drogave

Ekspertët kanë njoftuar se shumica e drogave të paligjshme perceptohen si lehtësisht të arritshme në rajon, sidomos në qytetet e mëdha (shih gjithashtu seksionin COVID-19 dhe disponueshmëria e drogave). Ka disa të dhëna sasiore në dispozicion lidhur me perceptimin rreth disponueshmërisë së

### COVID-19 dhe disponueshmëria e drogave

Në mënyrë të ngjashme me gjetjet nga BE-ja, duket se ndikimi i pandemisë COVID-19 në përdorimin dhe disponueshmërinë e drogave ka qenë më i fortë në rastin e substancave që blihen dhe përdoren zakonisht në mjediset e jetës së natës, të cilat nuk ishin të arritshme gjatë periudhave të distancimit social dhe bllokimeve (EMCDDA, 2021b). Opinioni i ekspertëve sugjeron se qëndrueshmëria relative e pjesëve të tregut të drogës gjatë pandemisë mund të shpjegohet me ekzistencën e rrugëve të shkurtra për furnizimin e kanabisit, stoqeve potencialisht të mëdha të kokainës dhe heroinës ose zinxhirëve të pandërprerë të furnizimit. Gjithashtu, duket se tregjet online janë bërë një burim më i rëndësishëm furnizimi gjatë pandemisë COVID-19, kur kufizimet e lëvizjes pengonin që njerëzit të përdornin droga nga ndërveprimi me tregtarët në mënyrën e zakonshme (EMCDDA, 2021a).

FIGURA 2
**Perceptimi i disponueshmërisë së drogave sipas ESPAD 2019: Nxënësit 15 deri në 16 vjeç të cilët janë përgjigjur se substanca mund të gjendet "mjaft lehtë" ose "shumë lehtë"**




Burimi: ESPAD, 2021.

substancave nga sondazhi ESPAD 2019, në të cilin kanë marrë pjesë nxënës të moshës 15 deri në 16 vjeç (ESPAD, 2021) nga katër vende të Ballkanit Perëndimor. Rezultatet nga këto vende mund të krahasohen me ato të të gjitha vendeve që kanë marrë pjesë në studimin ESPAD (SHIH Figurën 2). Për shembull, në krahasim me mesataren e raportuar në të gjitha vendet pjesëmarrëse në studim, në Malin e Zi dhe Serbi ka qenë më e lartë përqindja e studentëve që kanë raportuar se kokaina dhe stimuluesit sintetikë mund të disponoheshin mjaft lehtë ose shumë lehtë.

## Dëmet

Secili vend në rajon ka vlerësime lokale ose kombëtare të popullsive që paraqesin modele me rrezik të lartë të përdorimit të drogave, duke përfshirë përdorimin e opioideve dhe injektimin. Megjithatë, të dhënat aktuale janë shumë të vjetra në shumë raste dhe informacioni i rëndësishëm metodologjik dhe kontekstual është shpesh i paarritshëm. Prandaj, informacioni i disponueshëm në këtë fushë është i vështirë për t'u vlerësuar ose përdorur si bazë për krahasime.

Të dhënat për vdekjet e lidhura me drogën janë në dispozicion për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Në të katërta rastet, opioidet janë të pranishme në shumicën e vdekjeve të regjistruara të lidhura me drogën, megjithëse në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri vdekjet e lidhura me kokainën janë gjithashtu relativisht të zakonshme, në mënyrë proporcionale, midis të gjitha substancave në vdekjet e regjistruara. Opioidet hasen shpesh në kombinim me substanca të tjera – zakonisht, me alkool, benzodiazepina ose opioide të tjera. Megjithatë, duhet kujdes kur interpretohen këto të dhëna pasi nivelet e kryerjes së autopsive në rajon janë të ulëta, ekzaminimet toksikologjike mund të mos kryhen gjithmonë dhe mbulimi i burimeve të të dhënave është shpesh i paplotë.

Vendet në rajon raportojnë norma relativisht të ulëta të HIV te njerëzit që injektojnë droga, megjithëse të dhënat në dispozicion janë të kufizuara dhe shpesh të vjetra. Vlerësimet e përhapjes së antitrupave ndaj virusit të hepatitit C (HCV) te njerëzit që injektojnë droga variojnë nga 24% në Kosovë deri në 79% në Maqedoninë e Veriut – nivele që janë përgjithësisht të krahasueshme me ato nga BE-ja (nga 13% deri në 86% në të gjithë shtetet anëtare në vitin 2020) (EMCDDA, 2022).

## Përgjigjet lidhur me përdorimin e drogave dhe dëmet

### Parandalimi

Parandalimi është një fushë prioritare e qartë në dokumentet e politikave kombëtare për drogat në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, në rastet kur janë ekzistuese. Ndërsa sistemet kombëtare të parandalimit ndryshojnë, është e zakonshme që ato të fokusohen në ofrimin e iniciativave parandaluese në mjediset arsimore. Qasjet e përdorura në këto mjedise përfshijnë programe të

orientuara drejt zhvillimit të aftësive, efikasiteti i të cilave është disi i provuar, fushata ndërgjegjësimi të zbatuara nga organizatat ligjzbatuese dhe leksione të veçanta në lëndë të tilla si biologjia. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia kanë së paku një ekspert të trajnuar në Kurrikulën Evropiane të Parandalimit (EUPC), i cili ofron udhëzime për ato programe që kanë dëshmuar se shoqërohen nga rezultate pozitive. Bosnjë dhe Hercegovina ka përkthyer udhëzimet EUPC dhe ka filluar trajnimin e vendim-marrësve në të gjithë vendin. Serbia ka tashmë një sistem akreditimi për programet e parandalimit dhe Maqedonia e Veriut planifikon të zbatojë udhëzimet ndërkombëtare në vitet e ardhshme.

### Reduktimi i dëmeve

Sistemet kombëtare të monitorimit duket se janë të pajisura më mirë për të monitoruar infeksionin HIV sesa atë HCV, me testim diagnostikues të disponueshëm, shumë shpesh në mënyrë rutinore, për infeksionin me HIV, por jo për atë me HCV. Për sa i përket trajtimit, antiviralët me veprim të drejtpërdrejtë, të cilët janë shumë efektivë për trajtimin e HCV-së, janë në dispozicion në të gjitha vendet e rajonit përveç Maqedonisë së Veriut, megjithëse kufizimet ose pengesat për përdorimin e tyre janë raportuar në Shqipëri, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbi (Maticic e të tj., 2020; OBSH, 2019).

Shërbimet për reduktimin e dëmeve janë në dispozicion në të gjitha vendet e rajonit, por nivelet e shërbimeve ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Në raste kur shërbimet janë të disponueshme, ofrohen zakonisht gjilpëra dhe shiringa të pastra, këshillim, testim për disa sëmundje infektive, mbështetje sociale dhe masa të tjera shëndetësore dhe mbështetëse. Me përjashtim të Serbisë, ku këto shërbime administrohen nga instituti i shëndetit publik, reduktimi i dëmeve ofrohet kryesisht nga organizatat jo-qeveritare. Shtrirja, qasja dhe shpërndarja gjeografike e shërbimeve ndryshojnë nga vendi në vend dhe duket se ato varen kryesisht nga disponueshmëria e burimeve buxhetore. Ofrimi i këtyre shërbimeve në rajon ka qenë historikisht i brishtë dhe i varur nga mbështetja e donatorëve ndërkombëtarë. Ndryshimet e fundit lidhur me përzgjedhshmërinë dhe tërheqjen e mëvonshme të fondeve nga projektet e Fondit Global në disa vende në rajon duket se e kanë bërë situatën e OJQ-ve të angazhuara në ofrimin e këtyre shërbimeve veçanërisht të pasigurt (EMCDDA, 2021b; Shaw, 2022). Në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, qeveritë kombëtare i bashkëfinancojnë tashmë programet për reduktimin e dëmeve nga buxhetet e tyre shtetërore.

Një vlerësim i ri i situatës sugjeron se reduktimi i dëmeve është i pamjaftueshëm për të përmbushur nivelet e mundshme të nevojave në disa vende, veçanërisht në Shqipëri dhe Bosnjë dhe Hercegovinë (Shaw, 2022). Për shembull, objektivi i vitit 2020 i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për shpërndarjen e shiringave ishte të siguronte një mbulim prej 200 shiringash sterile në vit për secilin person që injekton droga (OBSH, 2017). Mbulimi i vlerësuar i programeve për gjilpëra dhe shiringa varion nga 6 shiringa sterile në vit për çdo person që injekton droga në Serbi deri në 74 në Malin e Zi (UNAIDS, 2022). Megjithëse vlerësohet se mbulimi në Bosnjë dhe Hercegovinë ka arritur 142 shiringa për çdo person që injekton droga në vitin 2016, kjo shifër përfaqëson situatën përpara reduktimit thelbësor të dëmeve, por nuk disponohen të dhëna më të reja (Shaw, 2022).

### Trajtimi

Modalitetet e trajtimit në dispozicion në vendet e rajonit përfshijnë zakonisht detoksifikimin, kujdesin në spital për pacientët dhe trajtimin e pacientëve të jashtëm. Trajtimi me agonistë opioidë ([4]) me metadon dhe buprenorfinë është në dispozicion në të gjitha vendet. Vlerësimet lidhur me mbulimin e trajtimit me agonistë opioidë janë në dispozicion për katër vende në rajon dhe variojnë nga 11% e njerëzve që përdorin opioide në Shqipëri dhe Bosnjë dhe Hercegovinë deri në 31% në Maqedoninë e Veriut (UNAIDS, 2022). Ndërsa këto shifra tregojnë se mbulimi është nën objektivin e rekomanduar OBSH 2020 prej 40 % (OBSH, 2017), nuk është e qartë se si janë llogaritur normat e mbulimit dhe duhet të tregohet kujdes lidhur me besueshmërinë e vlerësimeve të disponueshme.

Informacioni ekzistues sugjeron se trajtimi ofrohet në mënyrë gjeografikisht të pabarabartë brenda rajonit, me mbulimin më të madh në qytetet kryesore. Në Shqipëri, për shembull, klientët duhet të udhëtojnë në Tiranë për çdo trajtim me përjashtim të terapisë me metadon. Në Maqedoninë e Veriut, pjesët rurale të vendit kanë vetëm qasje të kufizuar në trajtimin me agonistë opioidë, megjithëse janë bërë përmirësime gjatë pandemisë COVID-19.

Ndërsa programet për reduktimin e dëmeve ofrohen kryesisht nga OJQ-të, trajtimi për droga ofrohet kryesisht nga institucionet shëndetësore publike, megjithëse ka disa përjashtime. Për shembull, në Kosovë, ofruesi kryesor i trajtimit për droga është OJQ Labyrinth, ndërsa në Shqipëri, OJQ Aksion Plus është ofruesi i vetëm i trajtimit me metadon. Kostot e trajtimit të varësisë nga drogat mbulohen zakonisht nga skemat kombëtare të sigurimit shëndetësor. Ekzistojnë gjithashtu qendra private trajtimi, komunitete

([4]) "Trajtimi me agonistë opioidë" përdoret këtu si termi i preferuar për të mbuluar një sërë trajtimesh që përfshijnë përshkrimin e agonistëve opioidë për të trajtuar varësinë nga opioidet. Lexuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se ky term përfshin trajtimin zëvendësues të opioideve, i cili mund të përdoret ende në disa prej mjeteve të mbledhjes së të dhënave dhe dokumenteve historike të EMCDDA-së.

terapeutike dhe programe të drejtuara nga komunitetet fetare, por tani për tani këta ofrues shërbimesh përgjithësisht nuk marrin pjesë në raportimin kombëtar dhe për këtë arsye informacioni mbi klientët e tyre dhe shërbimet që ata ofrojnë është i kufizuar.

Përdoruesit e opioideve përfaqësojnë shumicën e klientëve të trajtuar në qendrat e trajtimit në rajon, megjithëse kjo mund të përcaktohet kryesisht nga fakti se ky është trajtimi kryesor që ofrohet në qendrat pjesëmarrëse në ushtrimet e raportimit. Numri i klientëve që trajtohen për droga të tjera është përgjithësisht i ulët, megjithëse disa qendra (për shembull Spitali Universitar Nënë Tereza në Tiranë ose qendra Labyrinth në Kosovë) raportojnë raporte të konsiderueshme të përdoruesve të kokainës midis klientëve të tyre. Ekspertët kanë raportuar mungesën e përgjithshme të opsioneve të trajtimit për përdoruesit e substancave jo-opioide, burime të papërshtatshme për mbështetjen psiko-sociale dhe programe të pamjaftueshme ose jo-ekzistuese të fokusuara në ri-integrimin social për ata që largohen nga kujdesi.

Intervistat me praktikuesit tregojnë se një numër njerëzish më të pasur që kërkojnë trajtim për varësinë nga drogat mund të ndjekin opsione në vende të tjera, gjë që mund të ketë lidhje me stigmën ose me shërbimet që ofrohen në nivel lokal.

## Ndikimi i tregjeve të drogave në Ballkanin Perëndimor

Rajoni është një zonë e rëndësishme për rrjedhat ndërkombëtare të drogave. Rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor të përfshira në aktivitetet e trafikimit të drogave kanë një ndikim të rëndësishëm në çështjet e lidhura me sigurinë, qeverisjen, ekonominë dhe shtetin e së drejtës në rajon, duke kontribuuar gjithashtu në kriminalitetin e vendeve të BE-së, ku ato kanë një prani operacionale.

### Siguria

Drogat hyjnë në Ballkanin Perëndimor nëpër një numër rrugësh të ndryshme, secila prej të cilave shoqërohet me sfida të veçanta për sigurinë dhe zbatimin e ligjit. Kokaina dhe heroina, për shembull, importohen në këtë zonë nëpërmjet porteve të Adriatikut, të cilat duket se kanë çdo herë e më shumë rëndësi për rrjetet kriminale, veçanërisht për ato me bazë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ka mundësi që kjo ka ndikuar edhe në situatën e sigurisë së qyteteve pranë këtyre porteve (p.sh. porti i Durrësit në Shqipëri dhe porti i Barit në Malin e Zi), sepse atje janë thellë të rrënjosura një sërë aktivitetesh kriminale që mbështesin importin e drogave, siç janë praktikat korruptive dhe bizneset e lidhura me magazinimin, transportin dhe pastrimin e parave.

Një kërcënim akut për sigurinë lidhur me drogat në Ballkanin Perëndimor është dhuna që lidhet me konkurrencën për tregjet e drogave dhe rrugët e trafikimit ose që lind nga mosmarrëveshjet midis rrjeteve kriminale rivale (EMCDDA dhe Europol, 2022; LALA, 2021; OCCRP, 2020 – shih gjithashtu fushën "Lidhjet midis huliganizmit të futbollit dhe aktiviteteve të paligjshme").

Ka gjithashtu raporte për anëtarët e rrjeteve kriminale ndërkombëtare që veprojnë në Ballkanin Perëndimor ose që bashkëpunojnë me rrjetet kriminale me bazë në rajon. Për shembull, thuhet se anëtarët e rrjeteve kriminale italiane dhe turke po i shmangen drejtësisë, duke u lokalizuar në Ballkanin Perëndimor, ndërsa mendohet se organizatat kriminale ruse janë të përfshira në aktivitete të pastrimit të parave përgjatë vijës bregdetare të rajonit (Duvar, 2021; Jeremic e të tj., 2021; Kajtricitabine, 2021). Ka disa raporte gjithashtu lidhur me kriminelët dhe rrjetet kriminale me bazë në Amerikën Latine.

#### Lidhjet midis huliganizmit të futbollit dhe aktiviteteve të paligjshme

Në shkurt 2021, autoritetet serbe kanë arrestuar një nga udhëheqësit e grupit të huliganëve të futbollit Janjiçari, i cili ka lidhje me një rrjet malazez të trafikantëve të drogave, kontraktorë privatë në fushën e sigurisë dhe një numër zyrtarësh të lartë (Dragojlo, 2021). Një studim i ri për huliganizmin e futbollit në Ballkanin Perëndimor sugjeron se disa grupe në Serbi dhe në një masë më të vogël në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Maqedoninë e Veriut, kanë qenë të përfshirë në shpërndarjen dhe shitjen e drogave. Duket se këto grupe shfrytëzojnë anëtarët e rinj dhe i inkurajojnë që të marrin pjesë në aktivitetet e tregtimit të drogave. Raportohet se të njëjtat grupe janë përdorur gjithashtu për të shkaktuar përçarje në emër të disa politikanëve dhe për t'u përfshirë në vjedhje, grabitje dhe trafikun e armëve (Djordjevic dhe Scaturro, 2022).

### Qeverisja dhe sundimi i ligjit

Rrjetet kriminale që veprojnë në vende me qeverisje të dobët përgjatë rrugëve të trafikimit në rajon raportohet të kenë zhvilluar lidhje me disa biznese dhe zyrtarë lokalë (GI-TOC, 2019). Kur ekzistojnë aleanca të tilla, ato paraqesin një kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë dhe qeverisjen e mirë (shih fushën Simbioza midis rrjeteve kriminale dhe praktikave korruptive të nivelit të lartë).

#### Simbioza midis rrjeteve kriminale dhe praktikave korruptive të nivelit të lartë

Në disa vende të rajonit, raportohet se ekziston një marrëdhënie simbiotike midis rrjeteve kriminale dhe elitave të larta, duke rezultuar në praktika korruptive. Këto mund të përfshijnë sigurimin e qasjes preferenciale në kontratat e prokurimit publik, gjë që dëmton parimin e kushteve të barabarta, pengon investitorët potencialë dhe devijon burimet publike tek organizatat kriminale, duke penguar kështu zhvillimin (Zvekic dhe Roksandic, 2021). Është raportuar se në disa raste trafikantët e mëdhenj të drogave mund t'i shmangen ndjekjes penale ose, atje ku është arritur të jepen dënime, vendimet gjyqësore me sa duket janë shfuqizuar (Zvekic dhe Roksandic, 2021).

Ka gjithashtu tregues se fitimet nga tregtimi i drogave po përdoren për të minuar shtetin e së drejtës në rajon (shih gjithashtu fushën "Pastrimi i të ardhurave nga krimet e lidhura me drogat"). Në disa vende raportohet që kjo ka krijuar një cikël, ku paratë e drogave mundësojnë mbrojtjen, ndërsa mbrojtja mundëson dhe mbështet aktivitetet e paligjshme. Raportohet gjithashtu se rrjetet kriminale të përfshira në tregtinë e drogave kanë kërcënuar, dhënë ryshfet ose shantazhuar zyrtarë të lartë (Reitano dhe Amerhauser, 2020). Në korrik 2021, një prokuror dhe dy oficerë policie ishin ndër 38 personat e arrestuar për vepra penale lidhur me drogat, korrupsionin, shpërdorimin e pozitës zyrtare dhe pastrimin e parave në kontekstin e një operacioni ndërkombëtar dyvjeçar të udhëhequr nga Italia (Euronews, 2021).

## Socioekonomia dhe cenueshmëria

Disa vende, të vendosura përgjatë rrugëve të trafikimit në rajon, të cilat karakterizohen nga cenueshmëria socio-ekonomike dhe qeverisja e dobët, duket se janë bërë objektiva tërheqës për aktivitetet e rrjeteve kriminale. Në këto zona, të rinjtë dhe të papunët mund të tërhiqen nga perspektiva e fitimit të një sasie të konsiderueshme parash nga pjesëmarrja në tregtimin e drogave, sidomos kur mungojnë alternativa punësimi. Kështu, në disa komunitete të nënzhvilluara, këta faktorë mund të kenë krijuar një grup të rinjsh që janë të cenueshëm ndaj pjesëmarrjes në rrjetet kriminale, brenda ose jashtë vendit.

Në disa komunitete rurale, duket se edhe ekonomitë lokale janë bërë të varura nga të ardhurat që rrjedhin nga kultivimi i kanabisit. Sulmet kundër kultivimit të kanabisit në Shqipëri që nga viti 2016, mund të kenë kontribuar në një rritje në migrimin drejt zonave të tjera të vendit dhe jashtë tij, situatë që është përkeqësuar nga mungesa e burimeve alternative të të ardhurave.

### Pastrimi i të ardhurave nga krimet e lidhura me drogat

Të ardhurat nga trafiku i drogës raportohet të jenë fshehur dhe pastruar në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet ndërtimeve dhe pronave të patundshme, pikave të lojërave të fatit dhe bizneseve intensive me para të gatshme. Pastrimi i parave me anë të pronave, duke përdorur potencialisht të ardhura nga tregtimi i drogave, mund të ketë kontribuar në një rritje në çmimet e pasurive të patundshme në një numër zonash, të tilla si Beogradi, Tirana dhe përgjatë bregdetit Adriatik, megjithëse përmasat e kësaj rritjeje janë të vështira për t'u vlerësuar. Shumë ndërtesa raportohet se kanë mbetur bosh pas përfundimit, duke dëshmuar potencialisht pastrimin e parave. Në Malin e Zi, rrjetet kriminale Kavač dhe Škaljari supozohet se kanë prona me vlerë prej më shumë se 27 milionë EUR (CDM, 2017).

## Roli dhe ndikimi i rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor në tregjet e drogave të BE-së

Rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë aktive edhe në BE, e cila përfaqëson një treg fitimprurës drogash në afërsi gjeografike të ngushtë (Figura 3). Aktivitetet e tyre në BE duket se mbështeten edhe nga prania e diasporave të mëdha nga rajoni, duke siguruar një grup individësh që mund të shfrytëzohen ose të rekrutohen në këto rrjete.

Rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor duket se janë bërë aktive në BE në vitet 1990, si pasojë e luftës dhe paqëndrueshmërisë në rajon. Duket se kriminelët nga Ballkani Perëndimor kanë tendencë për t'u përqendruar në vende ku ka një diasporë të konsiderueshme. Për shembull, rrjeti kriminal i Maqedonisë së Veriut i njohur si "mafia e Frankfurtit" raportohet së është i përfshirë në trafikimin e heroinës nga Ballkani Perëndimor në Frankfurt dhe Vjenë (Kemp, 2020a; Marusic, 2013). Është raportuar gjithashtu prania e kriminelëve nga Shqipëria dhe ish-Jugosllavia në Sllovaki (Holcová e të tj., 2019), ndërsa anëtarët e rrjetit të njohur si "Jugomafia" kanë vepruar si zbatues dhe trafikantë drogash në Holandë dhe Suedi (GI-TOC, 2020; Kemp, 2020a). Këto rrjete thuhet se janë të përfshira gjithashtu në aktivitete të paligjshme të tjera që nuk janë të lidhura me drogat, të tilla si kontrabanda e armëve dhe cigareve në Itali në vitet 1990, por kanë zgjeruar aktivitetet e veta në fusha të

FIGURA 3
**Ngjarjet e përzgjedhura të trafikimit të drogave në vendet e BE-së lidhur me rrjetet kriminale të organizuara të Ballkanit Perëndimor**




Burimet: EMCDDA dhe GI-TOC.

tjera gjatë tri dekadave të fundit. Intervistat me ekspertë dhe burimet e tjera tregojnë se këto rrjete janë tani lojtarë kyçë në tregjet e drogës së BE-së, duke zgjeruar portofolin e tyre nga heroina dhe kanabisi për të përfshirë kokainën dhe, në një masë më të vogël, drogat sintetike (Kemp, 2020a).

Situata e tanishme është se një sërë burimesh tregojnë se rrjetet kriminale nga Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia janë të përfshira në një sërë aktivitetesh kriminale, duke përfshirë vjedhjen e makinave dhe mallrave të tjera luksoze, ndërsa grupet nga Shqipëria raportohet të kenë zhvilluar një reputacion për grabitjen e pronave dhe makinave luksoze në Evropën Perëndimore (GI-TOC, 2021a). Ka tregues gjithashtu se rrjetet kriminale shqiptare janë të përfshira kohët e fundit në trafikun e drogave në shkallë të gjerë, duke përfshirë raporte se ata kanë lidhje të ngushta bashkëpunimi me 'Ndrangheta-n italiane. Në nëntor 2021, një shqiptar është arrestuar në Itali pasi 467 kilogramë kokainë janë gjetur në kamionin që ai drejtonte (Lider, 2021).

## Trafikimi i kokainës: një pikë kthese për rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor

Përfshirja në trafikun e kokainës duket se është një pikë kthese për rrjetet e Ballkanit Perëndimor, duke konsoliduar rolin e tyre si lojtarë kyç në tregun e drogave të BE-së. Këto grupe kanë rritur gradualisht pjesëmarrjen e vet në tregtimin e kokainës dhe tani ekzistojnë prova se ato po orkestrojnë operacionet e trafikimit nga Amerika Latine direkt në portet evropiane (EMCDDA dhe Europol, 2022). Disa nga këto rrjete janë bërë gjithashtu aktorë të shquar në shpërndarjen me pakicë në BE (shih gjithashtu pjesën "Kokaina": përdorimi dhe furnizimi).

Megjithëse pjesëmarrja e tyre në tregtimin e kokainës duket të jetë rritur kohët e fundit, konsiderohet se rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor kanë pasur një prani operacionale në Belgjikë dhe Holandë për më shumë se një dekadë, duke përdorur këto vende si qendra për importin dhe shpërndarjen e drogave – sidomos të kokainës. Zgjedhja e këtyre dy vendeve lidhet ndoshta me rolin qendror që portet e Antverpit dhe Roterdamit luajnë tani në importin e drogave në BE. Në dhjetor 2020, dy figura kryesore nga një rrjet shqiptar janë arrestuar në Belgjikë për rolin e tyre në importimin e kokainës në Evropë nga Amerika Jugore (News24, 2020). Në një rast tjetër, në 2018, dy shtetas serbë janë arrestuar në Holandë dhe Belgjikë, së bashku me 1,7 milionë EUR, për të cilat dyshohet se janë të ardhura nga trafikimi i drogës (Pavlovic, 2018). Në prill 2019, qeveria holandeze ka kërkuar nga BE-ja që të pezullojë udhëtimin pa viza për shqiptarët, duke përmendur kërcënimin në rritje nga rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor dhe rolin e tyre të rëndësishëm në furnizimin e kokainës, pastrimit të parave dhe trafikimit të qenieve njerëzore (Schengenvisa News, 2019; Todd, 2019).

Megjithëse Belgjika dhe Holanda duket se kanë një vend qendror në operacionet e këtyre rrjeteve kriminale, konsiderohet se grupet nga Ballkani Perëndimor janë tani aktorë të rëndësishëm edhe në tregjet e kokainës, heroinës dhe kanabisit në vende të tjera të Evropës, të tilla si Gjermania, Italia, Spanja, Zvicra (Swissinfo.ch, 2019a, 2019b) dhe Mbretëria e Bashkuar. Për shembull, klanet Škaljari dhe Kavač nga Mali i Zi duket se kanë qenë aktivë në trafikimin e kokainës përmes Spanjës së paku që nga viti 2014 kur, sipas Kempit (2020b), një ngarkesë droge është zhdukur në Valencia, duke rezultuar në dhunë midis dy rrjeteve kriminale. Autoritetet gjermane kanë treguar gjithashtu se ekziston një lidhje midis rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor dhe rritjes në konfiskimin e kokainës që është vërejtur në portin gjerman të Hamburgut (BKA, 2021).

Ekzistojnë disa prova se grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor vazhdonin trafikimin e kokainës në portet e BE-së në fillim të pandemisë COVID-19. Për shembull, në fillim të majit 2020, 500 kilogramë kokainë janë kapur në një anije të regjistruar në Malin e Zi, e cila kishte lundruar nga Brazili përmes Mbretërisë së Bashkuar deri në portin e Hamburgut (EMCDDA, 2021a; Hakirevic, 2020).

## Evolucioni i përfshirjes së rrjeteve kriminale në prodhimin e kanabisit

Rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor raportohet të kenë rritur gjithashtu përfshirjen e tyre në prodhimin e kanabisit në BE gjatë 6 viteve të fundit, veçanërisht në lidhje me kultivimin intensiv në ambiente të brendshme. Një shembull mund të shihet në Spanjë, ku, në tetor 2016, 19 të dyshuar me origjinë kryesisht serbe janë arrestuar, 6 ambiente të brendshme për kultivimin e kanabisit janë shkatërruar dhe 50 690 EUR janë konfiskuar (Europol, 2016). Spekulohet se masat për të zvogëluar kultivimin e kanabisit në ambiente të jashtme në Shqipëri kanë rezultuar në riorientimin e rrjeteve kriminale, të cilat kanë kaluar në kultivimin intensiv në ambiente të brendshme, duke i zbatuar në vende të tjera më afër tregjeve të mëdha të konsumit në BE (Mejdini, 2021). Ky zhvillim është pasqyruar në një numër hetimesh ndërkombëtare të përbashkëta, të cilat janë kryer në kohën e fundit në BE kundër rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor, kryesisht kundër grupeve shqipfolëse dhe serbe (shih gjithashtu pjesën Kanabisi: përdorimi, prodhimi dhe furnizimi).

## Reputacion për dhunë

Mund të argumentohet se përdorimi i dhunës është një pjesë e arsyes pse rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë konsoliduar fort në aktivitetet ndërkombëtare të trafikimit të drogave, si në konkurrencë ashtu edhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë (shih gjithashtu Figurën 3). Këto grupe duken veçanërisht të përgatitura për të përdorur dhunën si një mjet strategjik për të pohuar autoritetin e vet mbi grupet ose individët e tjerë të përfshirë në tregun e drogave (Kemp, 2020b).

Për shembull, ka pasur një numër përplasjesh të armatosura në Shqipëri lidhur me konkurrencën mbi shpërndarjen e drogave ose me mosmarrëveshjet midis rrjeteve kriminale që nganjëherë e kanë zanafillën në konfliktet lidhur me aktivitetet e tregtimit të drogave në vendet e BE-së ose diku tjetër (EMCDDA dhe Europol, 2022; Lala, 2021; OCCRP, 2020). Një shembull i prirjes së disa rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor për të përdorur dhunë mund të shihet në hetimet e fundit në platformën e komunikimit të koduar Sky ECC, të cilat kanë treguar akte të torturës që duket se kanë ndodhur në vitin 2020 në Beograd (Piel dhe Saintourens, 2022).

Një numër vrasjesh të lidhura me tregtinë e kokainës dhe rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor janë raportuar në vitet e fundit në BE. Përfshirja e gjerë e këtyre grupeve në tregun evropian të kokainës tregohet nga fakti se vrasjet janë shënuar në qytete duke përfshirë Vjenën (Amerhauser, 2019), Amsterdamin (Avdic, 2019), Athinën (Kajosevic, 2020), Romën (De Risi, 2020), Malagën dhe Berlinin (Kemp, 2020b). Përveç kësaj, midis 2018 dhe 2020 ka pasur së paku nëntë vrasje dhe dy vrasje në tentativë në Afrikën e Jugut (rreth Johanesburgut), në të cilat janë përfshirë serbë të lidhur me rrjetet kriminale ose organizatat paraushtarake (Kemp, 2020a).

Pjesa më e madhe e kësaj dhune duket se ndodh midis grupeve të përfshira në aktivitete kriminale. Duket se brenda BE-së, rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor përpiqen të mbajnë një profil të ulët dhe të shmangin tërheqjen e vëmendjes ndaj aktiviteteve të veta si pasojë e veprimeve të dhunshme të raportuara publikisht. Megjithatë, duket se ata kanë akoma një kapacitet të konsiderueshëm në këtë zonë dhe raportohet se kanë qasje në një arsenal të gjerë armësh, duke filluar nga pistoletat dhe pushkët automatike deri te pushkët snajper dhe bombat e telekomanduara (OCCRP, 2020; Politiko, 2022a).

## Përdorimi i vendeve të BE-së për transit dhe fshehje

Disa vende të BE ndodhen në rrugët e trafikimit që kalojnë nëpër Ballkanin Perëndimor para se të rihyjnë në BE. Kjo do të thotë se rrjedhat e trafikimit mund të jenë komplekse. Për shembull, janë krijuar rrugë të rëndësishme për trafikimin e heroinës dhe kokainës nëpër mjet Bullgarisë, Kroacisë, Greqisë dhe Rumanisë, nga ku drogat hyjnë në Ballkanin Perëndimor për t'u shpërndarë në nivel lokal, por edhe për t'u transportuar në vende të tjera, duke përfshirë vendet e BE-së.

Megjithëse rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor duket të jenë të përfshira kryesisht në importin e kokainës përmes porteve të mëdha të BE-së, raportohet një rritje në trafikimin e kokainës përmes porteve në Shqipëri dhe Malin e Zi, si dhe në disa vende të tjera të BE-së, të tilla si Rumania (Rudic, 2019). Kjo sugjeron që këto rrjete kanë diversifikuar taktikat e tyre për lëvizjen e drogës në tregun e BE-së, gjë që mund të përfaqësojë një kërcënim të rëndësishëm në të ardhmen, veçanërisht në kontekstin e investimeve më të mëdha që po bëhen në masat ndaluese në portet hyrëse kryesore të njohura për trafikun e drogës në BE.

Vendet e BE-së luajnë edhe një rol tjetër të rëndësishëm për rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor, sidomos si vende ku kriminelët fshihen nga zbatimi i ligjit ose nga vëmendja e grupeve kriminale të tjera, me të cilat ata kanë mosmarrëveshje. Për shembull, një informacion anekdotik sugjeron se qytetet spa në vendet e BE-së gjeografikisht afër Ballkanit Perëndimor janë bërë destinacione popullore për kriminelët nga rajoni, ku ata pushojnë dhe shërohen.

Trafikimi i drogës, veçanërisht ndaj ose brenda BE-së, nga ana e kriminelëve prej Ballkanit Perëndimor, mundësohet gjithashtu nga përdorimi i dokumenteve të identifikimit të rreme ose të vjedhura. Siç tha një oficer nga Guardia Civil spanjolle: "një nga vështirësitë më të mëdha në gjurmimin e të arratisurve nga vendet e ish-Jugosllavisë është pikërisht lehtësia me të cilën ata mund të marrin dokumente të rreme" (Ortega Dolz, 2020). Duket se, së bashku me drogën, dokumentet e rreme të identitetit, armët dhe paratë konfiskohen shpesh prej rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor (Europol, 2020c; Nova, 2021).

## Aktivitetet kriminale më të gjera

Përveç përfshirjes në tregun e drogës, rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë të njohura edhe për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të tjera kriminale, të cilat mund të përfshijnë furnizimin me armë, trafikimin e njerëzve dhe pastrimin e parave. Këto tema shqyrtohen shkurtimisht më poshtë.

### Kontrabanda e armëve

Europoli vë në dukje se rrjetet kriminale të përfshira në trafikimin e armëve në BE e kanë origjinën kryesisht nga

Ballkani Perëndimor ([5]). Zakonisht këto armë janë mbajtur në mënyrë të paligjshme pas konflikteve të fundit në zonë ose janë përvetësuar pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Informacioni i mbledhur nga intervistat me ekspertë në këtë fushë sugjeron se asnjë nga këto rrjete nuk duket të merret ekskluzivisht me furnizimin e armëve; përkundrazi, ato janë të përfshira në një numër aktivitetesh të paligjshme, të tilla si trafikimi i drogave, dhe merren herë pas here me tregtinë e armëve. Shumëllojshmëria e armëve në dispozicion të grupeve të Ballkanit Perëndimor dhe që potencialisht mund të kontrabandohen në BE mund të ilustrohet nga raportet e policisë suedeze, të cilat tregojnë se kontrabandohen pistoleta, armë automatike dhe madje granata nga Ballkani Perëndimor dhe përdoren në dhunën e bandave (GI-TOC, 2020). Armët nga Ballkani Perëndimor kanë qenë të lidhura gjithashtu me ekstremistët e dhunshëm, terroristët dhe paraushtarakët. Për shembull, sulmet e vitit 2015 në Paris, Francë, duket se janë kryer me armë me burim nga Ballkani Perëndimor (The Economist, 2016). Armët mund të kontrabandohen në Ballkanin Perëndimor së bashku me dërgesat e drogës, ashtu siç dëshmohet nga konfiskimi i të dyja mallrave gjatë të njëjtit operacion (Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut, 2017; Zorić, 2020). Ka gjithashtu tregues se heroina dhe armët kontrabandohen së bashku nga Turqia në Kosovë.

### Migrimi i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore

Megjithëse rrugët e kontrabandës së emigrantëve janë të mbivendosura me ato të përdorura për të lëvizur drogën në gjithë Ballkanin Perëndimor, ka vetëm dëshmi të kufizuara se grupet e përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore ose kontrabandën e emigrantëve merren edhe me trafikimin e drogës (Kemp e të tj., 2021). Sidoqoftë, sa u përket lidhjeve midis drogave dhe migracionit të paligjshëm, ka pasur një numër raportesh për emigrantë që transportojnë droga me qëllim për të paguar për shërbimet e kontrabandës ose për konsum vetjak (Direktno, 2020; Jutarnji, 2016; Mondo, 2020). Për më tepër, besohet se anëtarët e një rrjeti të Ballkanit Perëndimor të përfshirë në kultivimin e kanabisit në BE kanë pasur lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, prostitucionin dhe pastrimin e parave (Europol, 2021a).

### Pastrimi i parave

Rrjetet kriminale nga Ballkani Perëndimor janë të njohura gjithashtu për pastrimin e të ardhurave nga trafiku i drogës në BE, si edhe në Ballkanin Perëndimor dhe vendndodhje offshore, duke përfshirë Emiratet e Bashkuara Arabe (Kemp, 2020a; Rettman, 2021).

Paratë e gjeneruara nga grupet që trafikojnë droga në Evropën Perëndimore dhe të pastruara më pas në Ballkanin Perëndimor kontrabandohen shpesh përtej kufijve në ndarjet e fshehura të makinave dhe kamionëve. Sipas një raporti të bazuar në intervista me shoferë kamionësh, korrierët e parave udhëtojnë rregullisht midis Shqipërisë dhe vendeve të BE-së ose Mbretërisë së Bashkuar dhe mbajnë shuma relativisht të vogla (më pak se 10 000 EUR) për të shmangur dyshimet (Reitano dhe Amerhauser, 2020). Të ardhurat e paligjshme nga krimi transferohen edhe nëpërmjet sistemit financiar, kompanive të transferimit të shpejtë të parave dhe operatorëve të sistemit "Havala" (Cartwright dhe Amerhauser, 2022; Europol, 2020b; Reitano dhe Amerhauser, 2020). Përveç kësaj, ekspertët kanë vënë në dukje rolin që kriptomonedhat mund të luajnë në transferimin e fondeve nga tregtia e drogës nga Ballkani Perëndimor dhe drejt tij (GI-TOC, 2021c).

([5]) Për më shumë informacion, shih https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-statistics/crime-areas/illicit-firearms-trafficking.

# Kanabisi: përdorimi, prodhimi dhe furnizimi

Megjithëse provat në dispozicion sugjerojnë se kanabisi është droga më e përdorur në rajon, mungojnë të dhëna të mirëfillta që do të na mundësonin të komentonim mbi prirjet dhe nivelet e përgjithshme të përhapjes. Ka disa tregues cilësorë lidhur me rritjen në përdorim, sidomos nga ana e të rinjve dhe disa vëzhgues kanë vërejtur një rritje në kërkesën për trajtim dhe në nevojën për një trajtim specifik për varësinë nga kanabisi.

Që nga viti 2016, konfiskimet sugjerojnë se metodat e kultivimit të kanabisit kanë ndryshuar në Ballkanin Perëndimor, me një rënie në prodhimin e kanabisit në ambiente të jashtme. Duket se ky është një ndikim i përpjekjeve të mëdha të çrrënjosjes në Shqipëri. Megjithatë, situata është bërë më e larmishme dhe më komplekse, me më shumë vende në rajon ku shënohen ambiente të jashtme për kultivimin e kanabisit në shkallë të gjerë. Përveç kësaj, një pjesë e kanabisit të prodhuar ligjërisht duket se ka përfunduar në tregun e paligjshëm. Duket se një numër rrjetesh kriminale nga rajoni janë gjithnjë e më të përfshira në kultivimin e kanabisit në BE.

## Kanabisi është droga më e konsumuar

Kanabisi është droga e paligjshme më e përdorur në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndër të rinjtë e moshës 15-34 vjeç, vlerësimet e përhapjes vjetore variojnë midis 1,9% për Bosnjë dhe Hercegovinën (2018) dhe 12,5% në Maqedoninë e Veriut (2017). Kjo është më e ulët se mesatarja e vlerësuar e BE-së prej 15,5% e të rinjve për vitin 2020. Siç u theksua më parë, nën-raportimi mund të jetë një problem për sondazhet e kryera në rajon.

Kanabisi bimor është forma më e zakonshme e kanabisit që përdoret në rajon. Kjo tregohet nga rezultatet e Ueb-Sondazhit Evropian mbi Drogat (EWSD) të vitit 2021, i cili është kryer në 5 vende në rajon dhe tregon se një mesatare prej 87% e atyre që kanë përdorur kanabis në 12 muajt e fundit kanë raportuar përdorimin e kanabisit bimor, ndërsa 24% kanë raportuar përdorimin e rrëshirës së kanabisit. Ndër të anketuarit, nivelet më të larta të raportuara për përdorimin e rrëshirës së kanabisit janë gjetur në Shqipëri (54%) dhe Kosovë (34%), ndërsa nivelet më të ulëtat janë vërejtur në Serbi (7%) dhe Malin e Zi (9%). Vaji ose ekstrakti i kanabisit ishte më popullori në Maqedoninë e Veriut (27%), ndërsa në vendet e tjera përdoruesit e raportuar të kanabisit ishin 10% ose më pak. Në të njëjtin studim, përdorimi i raportuar i kanabisit mjekësor ishte midis 1% dhe 2%, ndërsa shifrat e lidhura me përdorimin e produkteve të ligjshme të kanabisit, të markuara si CBD ose me THC të ulët, varionin midis 15% në Shqipëri dhe 40% në Maqedoninë e Veriut. Një gjë e rëndësishme është që rezultatet e EWSD-së nuk janë përgjithësuar te asnjë popullsi ose grup më i madh, duke marrë parasysh që në këtë studim është përdorur një mostër e vetë-emëruar jo e rastësishme. Kështu që, ndërsa këto rezultate mund të ofrojnë disa tregues se cilat droga përdoren nga njerëzit që marrin pjesë në sondazh, ato nuk mund të trajtohen si vlerësime përfaqësuese.

Shumë pak njerëz në rajon shkojnë në trajtim të specializuar për problemet e lidhura me kanabisin, sipas të dhënave paraprake mbi qasjen në trajtim që janë aktualisht në dispozicion. Një përjashtim është ndoshta Shqipëria, ku rreth një e dhjeta e njerëzve që shkojnë në trajtim çdo vit raportojnë kanabisin si problemin e tyre kryesor me drogat. Intervistat me praktikuesit si në Shqipëri ashtu edhe në Serbi kanë nxjerrë në pah përshtypjen e tyre se numri i të rinjve që kërkojnë ndihmë apo që kanë probleme lidhur me përdorimin e kanabisit po rritet. Numri i përgjithshëm i ulët i klientëve që shkojnë në trajtim për probleme të lidhura me kanabisin në rajon duhet të interpretohet brenda kontekstit të përgjithshëm të disponueshmërisë së kufizuar të shërbimeve për trajtimin e varësisë nga drogat, në veçanti, brenda kontekstit të disponueshmërisë së ulët të shërbimeve për njerëzit me probleme të lidhura me kanabisin.

## Konfiskimet rajonale të kanabisit bimor

Periudha 2017-2020 është karakterizuar nga një tendencë zbritëse në sasitë e kanabisit bimor të konfiskuar në rajon (shih Figurën 4). Ndërsa më shumë se 84 tonë janë

FIGURA 4
**Sasia totale e kanabisit bimor të konfiskuar në Ballkanin Perëndimor, 2017-2020**




Burimi: EMCDDA.

konfiskuar në nivel rajonal në vitin 2017, kryesisht në Shqipëri, sasia është ulur në mënyrë të ndjeshme në afërsisht 19,5 tonë në vitin 2019 dhe 14 tonë në vitin 2020.

## Diversifikimi i praktikave të kultivimit të kanabisit

Kanabisi duket se kultivohet si në ambiente të brendshme ashtu edhe në ato të jashtme në gjithë Ballkanin Perëndimor. Ekspertët kanë vërejtur se, atëherë kur kanabisi kultivohet në ambiente të jashtme, disa kriminelë shqiptarë duket se tani përdorin fara kanabisi të importuara nga Holanda, të cilat kanë një cikël më të shkurtër rritjeje (Brnad, 2022).

Që nga viti 2016, investimet në çrrënjosjen e kanabisit në Shqipëri janë në rritje dhe kjo duket se ka zvogëluar kultivimin e kësaj droge në ambiente të jashtme në shkallë të gjerë. Këto përpjekje çrrënjosjeje janë ndërmarrë në bashkëpunim me Guardia di Finanza italiane dhe përfshijnë vëzhgimin ajror për të gjetur vendet e plantacioneve të kanabisit në zona më të largëta dhe të vështira për t'u aksesuar. Si pasojë e këtyre përpjekjeve, Shqipëria duket se luan tani një rol më të vogël në prodhimin rajonal të kanabisit sesa në të kaluarën. Megjithatë, një aspekt i rëndësishëm këtu është se kultivimi intensiv i kanabisit në ambiente të brendshme duket se është tani më i zakonshëm si në Shqipëri ashtu edhe në vendet e tjera të rajonit (Brnad, 2022; Sinoruka, 2022).

Kohët e fundit janë identifikuar ambiente të brendshme dhe të jashtme për kultivimin e kanabisit në shkallë industriale në disa shtete të rajonit. Sipas raporteve, objekte me më shumë se 10 000 bimë janë shkatërruar në Serbi në nëntor 2019 (shih fushën "Plantacion i brendshëm kanabisi në shkallë industriale në Serbi"), në Kosovë në maj 2022 (RTKLIVE, 2022a) dhe në Maqedoninë e Veriut në qershor 2022 (Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut, 2022). Duke marrë parasysh shkallën e madhe të këtyre plantacioneve, duket se ka të ngjarë që një pjesë e kanabisit të prodhuar të ishte për eksport. Përveç kësaj, autoritetet në Malin e Zi kanë asgjësuar një plantacion të madh për kultivimin e brendshëm të kanabisit për herë të parë në atë vend në vitin 2021 (Brnad, 2022).

## Devijimi i mundshëm i kanabisit të ligjshëm në tregun e paligjshëm

Prodhimi i kanabisit për përdorim mjekësor është legalizuar në Maqedoninë e Veriut në vitin 2016. Midis shkurtit 2017 dhe tetorit 2021, 64 kompani janë raportuar të jenë të pajisura me licenca për kultivimin e kanabisit (Hall, 2021).

### Plantacion i brendshëm kanabisi në shkallë industriale në Serbi

Në nëntor 2019, policia serbe ka asgjësuar një plantacion të brendshëm kanabisi në shkallë industriale, i cili ishte fshehur brenda një ferme perimesh organike. Gjatë operacionit janë konfiskuar gati 4 tonë produkte kanabisi, nga të cilat 650 kilogram kanabis bimor. Përveç kësaj, janë gjetur një kartë identiteti policore e rreme dhe një makinë policie. Plantacioni mbrohej me pajisje teknike për interferimin e sinjaleve telefonike, roje të armatosura me pushkë anti-dronë dhe kamera termike për mbikëqyrjen gjatë natës.

Burimet: Reuters, 2019; Zorić, 2020.

Kohët e fundit ka tregues se një pjesë e kanabisit të prodhuar ligjërisht mund të devijohet në tregun e paligjshëm të drogës në Maqedoninë e Veriut ose kontrabandohet në vende të tjera. Për shembull, ka pasur dy raste që përfshijnë mbi 2 tonë kanabis të vjedhur nga magazinat e kompanive të licencuara në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020 (Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut, 2020a, 2020b). Ka gjithashtu tregues se prodhimi i paligjshëm i kanabisit mund të jetë ndërmarrë qëllimisht në ambiente të licencuara prodhimi. Për shembull, në shkurt 2022, policia ka konfiskuar rreth 1,5 tonë kanabis të padeklaruar nga një prej kultivuesve të regjistruar ligjërisht (Trkanjec, 2022). Në qershor 2022, qeveria shqiptare ka publikuar, për konsultim, një ligj që rregullon kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale (Regjistri Elektronik i Shqipërisë, 2022). Duke pasur parasysh shkallën e tanishme dhe rritjen e mundshme të prodhimit të ligjshëm të kanabisit brenda rajonit, një konsideratë e rëndësishme për të ardhmen është se si të sigurohet që në ambientet e prodhimit të mos infiltrohen rrjetet kriminale dhe si të vendosen masa të fuqishme për të parandaluar që kanabisi i prodhuar ligjërisht të arrijë në tregun e paligjshëm.

## Ekspertiza për kultivimin e kanabisit dhe operacionet kalojnë në BE

Rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor duket të jenë të përfshira si në trafikimin e kanabisit në BE nga vendet jashtë BE-së, duke përfshirë Ballkanin Perëndimor, ashtu edhe në kultivimin e kanabisit brenda BE-së (Byroja për Koordinimin Operacional, 2021; Europol, 2021e).

**Kultivimi i kanabisit në shkallë industriale në Spanjë ka rezultuar në vjedhje të energjisë elektrike me një vlerë të llogaritur prej 1,5 milionë euro.**

Në një hetim ndërkombëtar të përbashkët me mbështetjen e Europolit, Belgjikës dhe Holandës, Spanja ka shkatërruar një rrjet kriminal të përfshirë në kultivimin e kanabisit, i cili përbëhej kryesisht nga shtetas shqiptarë. Në një seri bastisjesh të koordinuara, pesë plantacione të brendshme kanabisi janë asgjësuar dhe më shumë se 34 000 bimë kanabisi janë kapur në tetor 2020. Kriminelët kanë vjedhur energji elektrike dhe ujë me një vlerë të llogaritur prej 1,5 milionë euro, të cilat i kanë përdorur në plantacione.

Plantacionet e brendshme prodhonin nga tri deri në katër të korra kanabisi në vit dhe ndodheshin në zona të qeta në rrethinat e Barcelonës. Kanabisi bimor transportohej në paleta me kamionë deri në Holandë. Rrjeti kriminal përdorte teknologji të koduara komunikimi për të lehtësuar biznesin e vet.

Burimi: Europol, 2020c.

Gjatë 6 viteve të fundit, rrjetet kriminale me bazë në Ballkanin Perëndimor duket të jenë përfshirë gjithnjë e më shumë në kultivimin e kanabisit në ambiente të brendshme në shtetet e BE-së (p.sh. Austria, Belgjika, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Spanja – Europol, 2019, 2020a, 2020c, 2021a, 2021c, 2021d; Ministria e Brendshme e Austrisë, 2021; Newsit, 2020) (shih gjithashtu pjesën "Roli dhe ndikimi i rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor në tregjet e drogave të BE-së"). Një nxitës i mundshëm i këtij zhvillimi është zvogëlimi i rreziqeve dhe kostove lidhur me gjetjen e objekteve për prodhimin e drogave afër tregut të tyre të synuar të konsumit (Brnad, 2022).

Në BE janë kryer disa hetime ndërkombëtare të përbashkëta kundër rrjeteve kriminale kryesisht shqipfolëse dhe serbe të përfshira në prodhimin e kanabisit (shih seksionin Kultivimi i kanabisit në shkallë industriale në Spanjë...). Në bazë të informacionit në dispozicion, Spanja duket të jetë vendndodhja më e zakonshme për krijimin e plantacioneve të kanabisit. Në shtator 2021, më shumë se 100 të dyshuar, kryesisht shqipfolës, janë arrestuar lidhur me menaxhimin e 51 plantacioneve të kanabisit në Spanjë (Europol, 2021c). Megjithatë, shtete të tjera janë prekur, duke përfshirë Belgjikën dhe Francën, ku policia ka arrestuar më shumë se 60 anëtarë të një rrjeti kriminal të organizuar shqipfolës, i cili ishte i lidhur me së paku një duzinë ambientesh të brendshme për kultivimin e kanabisit në prill 2019 (Europol, 2021a).

Në shtator 2020, është arrestuar një grua serbe e akuzuar për drejtimin e një rrjeti ndërkombëtar për trafikimin e kanabisit, të përbërë nga shtetas serbë, boshnjakë, kroatë dhe spanjollë, pasi janë konfiskuar 12 600 bimë dhe 190 kilogramë kanabis i përpunuar në Spanjë (ARVBL, 2020). Në operacione të tjera të zbatimit të ligjit, në janar dhe qershor 2021, mbi 40 anëtarë të një rrjeti kriminal serb janë vënë në shënjestër për përfshirjen e tyre në prodhimin dhe shpërndarjen e kanabisit bimor dhe rrëshirës së kanabisit në Spanjë (Europol, 2021d).

## Trafikimi i kanabisit bimor

Ballkani Perëndimor është një nga burimet e kanabisit bimor që trafikohet në BE. Trafikimi bëhet gjithashtu midis vendeve në rajon dhe gjithashtu në Turqi (shih seksionin "Trafikimi i kanabisit në drejtim 'të kundërt' të rrugës ballkanike"). Para vitit 2018, Shqipëria konsiderohej si një burim i rëndësishëm kanabisi bimor nga jashtë BE-së për tregun evropian (EMCDDA dhe Europol, 2019), një perceptim i konfirmuar nga konfiskimet e kryera në Ballkanin Perëndimor dhe vendet e BE-së. Megjithëse rrugët e trafikimit të kanabisit për në BE dhe vendet fqinje mbeten

**Trafikimi i kanabisit në drejtim "të kundërt" të rrugës ballkanike**

Turqia mbetet një destinacion kyç për kanabisin bimor nga Ballkani Perëndimor dhe ka tregues se kanabisi mund të shkëmbehet nganjëherë me heroinë (Brnad, 2022; Mejdini dhe Amerhauser, 2019; Sinoruka, 2022) ose kokainë (Departamenti i Shtetit i SHBA-së, 2022). Kjo mendohet të jetë një shenjë se dërgesat e drogës përgjatë rrugës ballkanike mund të bëhen më të dyanshme. Për shembull, produktet e kanabisit transportohen tani në "drejtim të kundërt" të rrjedhës normale të drogës, duke përdorur potencialisht të njëjtat rrjete, infrastrukturën kriminale dhe metodat e përdorura për trafikimin e heroinës në BE.

ende aktive (Brnad, 2022), që nga 2018 vendet fqinje, të tilla si Greqia, Italia dhe Maqedonia e Veriut, kanë raportuar një rënie të konsiderueshme në konfiskimin e kanabisit me origjinë shqiptare (UNODC, 2020). Ka informacione që sugjerojnë se nga kjo periudhë mund të jetë rritur prodhimi në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, në përgjithësi, Shqipëria nuk duket të jetë në këtë moment një burim aq i rëndësishëm i kanabisit bimor për tregun e BE-së sa ishte para vitit 2018.

Konfiskimet sugjerojnë se kanabisi bimor me origjinë nga Ballkani Perëndimor dhe i trafikuar në BE transportohet zakonisht nëpër kufijtë tokësorë, për shembull në Hungari (Ljubas, 2020; Pika fokale kombëtare Reitox e Hungarisë, 2020) dhe Kroaci (Ministria e Punëve të Brendshme e Kroacisë, 2019) (shih gjithashtu hartën e rrugëve kryesore të trafikimit të drogës në Ballkanin Perëndimor në Figurën 1). Ndonjëherë trafikohet edhe përmes rrugëve detare, në Greqi, Itali dhe Turqi (Daily Sabah, 2021). Pavarësisht nga ndonjë zvogëlim i mundshëm në prodhim, rajoni duket ende të jetë një burim i rëndësishëm kanabisi për disa vende të BE-së. Për shembull, afërsisht 48% e kanabisit të konfiskuar në Greqi në vitin 2020 mendohet se është me origjinë shqiptare, megjithëse kjo përbën një rënie në krahasim me vitet e mëparshme (p.sh. 62% në 2018 dhe 71% në 2017) (Brnad, 2022; Policia e Greqisë, 2020). Në mënyrë të ngjashme, sasia e përgjithshme e kanabisit bimor të trafikuar në Itali duket se është zvogëluar në vitet e fundit, ashtu siç tregohet nga rënia e vazhdueshme e konfiskimeve, duke marrë parasysh se konfiskohet më pak kanabis bimor gjatë transportimit të tij me anije të shpejta nëpër detin Adriatik (Halili, 2021a; Ministria e Punëve të Brendshme e Italisë, 2021). Megjithatë, duket se kjo rrugë është ende aktive, ashtu siç tregohet nga konfiskimi i 992 kilogramëve kanabis bimor në Detin Adriatik në gusht 2022, i cili transportohej me anije me vela dhe anije të shpejta. Me këtë rast, janë arrestuar tre të dyshuar shqiptarë dhe dy të dyshuar ukrainas (Velaj, 2022).

Konsiderohet se kanabisi mund të trafikohet me avionë të vegjël (Brnad, 2022; City News Albania, 2021; Ljubas, 2020) ose nganjëherë me pajisje ajrore pa pilot (dronë) (Vijesti, 2022). Megjithatë, këto mënyra transporti ka të ngjarë të jenë një përjashtim dhe jo rregulla.

Kompleksiteti i rrjedhave të trafikimit të kanabisit theksohet nga produktet e kanabisit që trafikohen nga BE në Ballkanin Perëndimor. Për shembull, ka tregues se fidanët e kanabisit nga BE-ja mund të transportohen në Ballkanin Perëndimor për t'u kultivuar. Në janar 2022, policia kroate ka konfiskuar 1096 fidanë kanabisi në kufirin me Malin e Zi nga një kamion me destinacion Maqedoninë e Veriut (Brnad, 2022; Ministria e Punëve të Brendshme e Kroacisë, 2022). Në qershor 2022, policia spanjolle ka shkatërruar një rrjet kriminal të organizuar që kultivonte kanabis të destinuar për shumë tregje evropiane të drogës, duke përfshirë tregun serb (Spanish News Today, 2022).

## Rrëshira e kanabisit dhe produktet e tjera: prodhimi dhe trafikimi

Megjithëse sasitë e përfshira të rrëshirës së kanabisit duken shumë të ulëta kur krahasohen me kanabisin bimor, konfiskimet e vogla të drogës tregojnë se Ballkani Perëndimor është gjithashtu një pikë transporti për rrëshirën e kanabisit dhe ndoshta një prodhues. Sasia e rrëshirës së kanabisit e konfiskuar në Shqipëri është rritur nga 23 kilogramë në 2016 deri në 1,1 tonë në 2019, para se të binte befas në 1 kilogram në 2020. Megjithatë, informacioni në dispozicion nuk mundëson nxjerrjen e përfundimeve për origjinën e rrëshirës së kanabisit të konfiskuar në Ballkanin Perëndimor.

Ka gjithashtu disa tregues se në rajon prodhohet vaj kanabisi. Për shembull, në vitin 2017, në Malin e Zi janë konfiskuar 17 litra vaj kanabisi, me origjinë të dyshuar nga Shqipëria, në transit drejt BE-së (EMCDDA dhe Europol, 2019).

Ka prova gjithashtu për lloje të ndryshme produktesh të kanabisit që trafikohen nga Ballkani Perëndimor në të njëjtën kohë. Për shembull, në shkurt 2020 autoritetet italiane kanë konfiskuar 450 kilogramë kanabis bimor, 75 kilogramë rrëshirë kanabisi dhe 3,5 litra vaj kanabisi në të njëjtën ngarkesë nga Shqipëria, ndërsa në prill 2020 janë arrestuar dy shtetas italianë për kontrabandën e 646 kilogramëve kanabis bimor dhe 250 kilogramëve rrëshirë kanabisi, gjithashtu nga Shqipëria (Guardia di Finanza, 2020; Kote, 2020).

## Çmimet e kanabisit

Një aspekt i rëndësishëm duhet të ngrihet para se të komentohet për çmimet e kanabisit ([6]), më saktë që të dhënat në dispozicion nuk janë të plota. Megjithëse kjo paraqet një shkallë pasigurie, mund të bëhen disa vëzhgime mbi këtë temë. Në bazë të të dhënave në dispozicion, çmimi mesatar me pakicë i kanabisit bimor në rajon midis 2018 dhe 2020 ishte afërsisht 6 EUR për gram, me çmimin mesatar më të ulët në Shqipëri (4 EUR/g) dhe çmimin më të lartë në Serbi (7,4 EUR/g). Megjithëse çmimi i kanabisit

([6]) Çmimet e drogave janë analizuar nga GI-TOC bazuar në të dhënat që vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë ofruar EMCDDA-së, si edhe në të dhënat e mbledhura nga GI-TOC (Kemp e të tj., 2021).

bimor raportohet në mënyrë konvencionale në EUR për gram në nivel të shitjes me pakicë dhe në EUR për kilogram në nivel të shitjes me shumicë, të dhënat e mbledhura në terren në periudhën 2019-2020 ofrojnë disa detaje interesante lidhur me volumet e transaksioneve. Për shembull, informacioni në dispozicion sugjeron se përdoruesit mund të blejnë kanabis bimor në sasi që variojnë nga 0,8 deri në 1,2 gram për një minimum prej 4 EUR në Shqipëri – ku është gjithashtu e mundur të blihen 10 gramë për një çmim të zbritur prej afërsisht 30 EUR (Kemp e të tj., 2021).

Informacioni në dispozicion sugjeron gjithashtu se midis viteve 2018 dhe 2020 çmimi mesatar i kanabisit bimor me shumicë në rajon ishte afërsisht 1600 EUR për kilogram, me çmimin mesatar më të ulët në Shqipëri (1300 EUR/kg) dhe çmimin më të lartë në Serbi (2300 EUR/kg). Në nivel të shitjes me shumicë, çmimi i 1 kilogram kanabis bimor duket se ndryshon ndjeshëm në varësi të mënyrës së prodhimit. Në Shqipëri, për shembull, kanabisi i kultivuar në ambiente të jashtme shitet nga 1200 deri në 1800 EUR për kilogram, ndërsa kanabisi i kultivuar në mjedise të brendshme shitet deri në 2400 EUR për kilogram. Mund të pritet që kultivimi intensiv i brendshëm të rezultojë në një kanabis bimor me një fuqi më të lartë në krahasim me atë të kultivuar në mjedise të jashtme, megjithëse nuk ka informacion mjeko-ligjor në dispozicion për ta konfirmuar këtë. Në Serbi, megjithatë, kanabisi i kultivuar në ambiente të brendshme me cilësi të lartë raportohet të shitet deri në 4000 EUR për kilogram.

Pasi kanabisi trafikohet përtej kufijve ndërkombëtarë, konsiderohet se ai shitet me një përfitim prej afërsisht 200 EUR për kilogram, megjithëse kjo ka të ngjarë të ndryshojë në varësi të sa kufij ka kaluar, cili është niveli i rrezikut të përfshirë dhe cilat janë mjetet e transportit të përdorura. Në rast të trafikimit me varka të shpejta (në vende të tilla si Italia ose Greqia), raportohet se rritja mund të arrijë deri në 700 EUR për kilogram (Kemp e të tj., 2021). Opinioni i ekspertëve sugjeron se çmimi i produkteve të kanabisit është rritur vitet e fundit si pasojë e aktiviteteve të zbatimit të ligjit, të tilla si konfiskimet në plantacione të mëdha, gjë që ka çuar në zvogëlim e furnizimit (Brnad, 2022).

# Kokaina: përdorimi dhe furnizimi

Raportohet se përdorimi i kokainës pluhur, injektimi i saj dhe përdorimi i kokainës krak janë në rritje në rajon. Ekspertët besojnë se tashmë përdorimi i kokainës është stabilizuar fort në rajon dhe, për këtë arsye, vdekjet lidhur me përdorimin e kokainës janë raportuar në disa vende në Ballkanin Perëndimor. Siç është theksuar më parë, ekziston mendimi se mungojnë të dhëna empirike të mirëfillta që do të na mundësonin të komentonim në mënyrë të besueshme lidhur me prirjet e përdorimit të drogës dhe nivelet e përhapjes.

Konfiskimet e fundit sugjerojnë se trafikimi i kokainës përmes porteve detare të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në Shqipëri dhe Malin e Zi, mund të jetë rritur: megjithëse sasitë në fjalë janë akoma shumë të vogla në krahasim me sasitë e konfiskuara në portet e mëdha të hyrjes së kësaj droge në BE. Informacioni nga burimet e zbatimit të ligjit sugjeron gjithashtu se rrjetet kriminale nga rajoni janë bërë lojtarë të mëdhenj në tregun e kokainës të BE-së. Nganjëherë kjo përfshin orkestrimin e operacioneve në tërë zinxhirin e furnizimit, nga prokurimi i drogës në Amerikën Latine dhe importimi i saj direkt në portet e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, deri në shpërndarjen e saj në rrugët e vendeve evropiane.

## Diversiteti në modelet e përdorimit të kokainës nga ana e të pasurve dhe të margjinalizuarve

Në bazë të të dhënave të disponueshme të sondazhit të përgjithshëm të popullsisë, kokaina është droga e dytë më e zakonshme në Ballkanin Perëndimor, pas kanabisit, megjithëse në këto të dhëna mund të nënvlerësohen format e përdorimit dhe substancat më të stigmatizuara, siç janë opioidet. Modelet e përdorimit të kokainës mund të variojnë nga përdorimi në mjedise rekreative te konsumatorët më të pasur deri në përdorimin me rrezik të lartë te popullsitë e margjinalizuara. Vitin e kaluar disponoheshin vlerësime për përhapjen në përdorimin e kokainës tek të rinjtë në disa vende, por këto të dhëna janë tani shumë të vjetra dhe nuk dihet se në çfarë mase ato pasqyrojnë situatën e tanishme. Për shembull, një vlerësim nga viti 2014 në Shqipëri për përhapjen në vitin e mëparshëm sugjeron se 3,6% e të rinjve e kishin provuar drogën. Në Malin e Zi kjo shifër ishte e ngjashme (3,7%) në vitin 2017. Sa për krahasim, mesatarja e BE-së për këtë masë në vitin 2020 ishte 2,2%, megjithëse janë vërejtur dallime të mëdha midis vendeve (EMCDDA, 2022). Sipas studimit ESPAD 2019, përdorimi i kokainës dhe kokainës krak në Malin e Zi është raportuar si relativisht i lartë ndër studentët 15 deri në 16 vjeç, me 2,9% dhe 1,4% përkatësisht (në krahasim me një përhapje mesatare të përdorimit të kokainës dhe kokainës krak prej 1,9% dhe 1,1% në nivel të të gjitha vendeve pjesëmarrëse në ESPAD në 2019) (ESPAD, 2021). Ekziston një përshtypje midis ekspertëve se përdorimi dhe numri i përdoruesve të kokainës është rritur kohët e fundit te klasa e mesme e zonave urbane çdo herë e më të pasura të Beogradit, Podgoricës dhe Tiranës, si edhe në vendpushimet e rajonit (të tilla si ato në bregdetin Adriatik ose në vendpushimet e skive si Jahorina në Bosnjë dhe Hercegovinë).

Përdorimi i kokainës ishte gjithashtu relativisht i lartë ndër të anketuarit e EWSD 2021. Midis atyre që kanë raportuar përdorimin e kokainës, pluhuri i kokainës ishte forma më e zakonshme e përdorur (mesatarisht 94% në pesë vende) ndërsa përdorimi i kokainës krak është raportuar shumë më pak (6%), megjithëse kjo shifër ishte më e lartë në Shqipëri (19%). Megjithatë, duket se sondazhi shqiptar për këtë ushtrim ka arritur klientët e programeve me prag të ulët dhe për këtë arsye dallimet e vërejtura mund të pasqyrojnë thjeshtësisht dallime lidhur me marrjen e mostrave dhe jo dallime të përgjithshme në modelet e përdorimit. Siç është theksuar më parë, EWSD është një ushtrim i vetë-emëruar online dhe për këtë arsye rezultatet nuk janë të përgjithësueshme për popullsinë në tërësi.

Injektimi i kokainës është raportuar gjithashtu në mënyrë sporadike në Maqedoninë e Veriut dhe së fundmi në Malin e Zi, ku kokaina raportohet të injektohet e vetme ose në kombinim me opioide (EMCDDA, 2021b). Vdekje të lidhura me kokainën janë raportuar gjithashtu në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut.

Shumë pak njerëz në rajon shkojnë në trajtim për probleme të lidhura me kokainën. Përjashtimi i dukshëm është Shqipëria, ku klientët që përdornin kokainë përfaqësonin midis një të tretës dhe gjysmës së të gjithë klientëve që marrin trajtim në Spitalin Universitar Nënë Tereza në Tiranë midis 2019 dhe 2020. Ekspertët kanë vënë në dukje se, në rajon në tërësi, shërbimet për njerëzit me probleme të lidhura me stimuluesit janë të pazhvilluara ose nuk ekzistojnë fare. Raportohet se stigmat sociale lidhur me problemet me drogat përfaqësojnë një pengesë për të kërkuar ndihmë dhe mund të shkaktojnë që individët më të pasur të kërkojnë trajtim jashtë vendit.

## Rritja e rolit të porteve të Ballkanit Perëndimor

Disponueshmëria e kokainës në BE është në nivelin më të lartë të të gjitha kohërave, me sasi rekord të konfiskuara në

Evropë çdo vit që nga viti 2017. Megjithëse ka pasur disa konfiskime të mëdha të drogës në rajonin e Ballkanit Perëndimor në të kaluarën, të dhënat vazhdojnë të sugjerojnë se, në përgjithësi, kontrabanda e kokainës në rajon kryhet në një shkallë shumë të kufizuar, kur krahasohet me vendet kyçe të BE-së (EMCDDA dhe Europol, 2022). Megjithatë, ka tani disa tregues se roli i rrjeteve kriminale dhe porteve të Ballkanit Perëndimor në tregtinë e kokainës në Evropë mund të jetë në rritje dhe kjo mund të përbëjë një kërcënim në të ardhmen.

Interpretimi i të dhënave mbi konfiskimin e kokainës në vendet e Ballkanit Perëndimor është mjaft sfidues, por zhvillimet më të fundit në këtë fushë janë shqetësuese. Rishikimi i të dhënave mbi konfiskimet e regjistruara të kokainës në rajon midis 2017 dhe 2020 tregon një rritje dramatike (shih Figurën 5), deri në gati 700 kilogramë në 2018. Sa për krahasim, kjo përfaqëson më pak se 1% të kokainës së kapur në BE në të njëjtin vit, por ky nivel konfiskimesh është i jashtëzakonshëm për rajonin sipas standardeve historike. Megjithatë, vlerat e vitit 2018 tregojnë kryesisht një konfiskim të madh prej 613 kilogramësh kokainë të kryer nga autoritetet shqiptare (Exit News, 2018). Përkundrazi, sasitë e kokainës të raportuara si të konfiskuara në vitet 2017 dhe 2020 ishin minimale, me një rënie të theksuar në sasitë e konfiskuara midis 2018 dhe 2019.

Megjithatë, kohët e fundit, të dhënat paraprake të disponueshme lidhur me konfiskimet në 2021 dhe 2022 tregojnë se roli i porteve detare në rajonin e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në Shqipëri dhe Malin e Zi, mund të jetë në rritje. Për shembull, raportet e mediave tregojnë se në portin e Durrësit të Shqipërisë, 143 kilogramë kokainë janë konfiskuar në prill 2021 (Exit News, 2021) dhe 119 kilogramë në dhjetor 2021 (Java News, 2022). Në mënyrë të ngjashme, në portin e Barit të Malit të Zi, 1,4 tonë janë konfiskuar në gusht 2021, ndërsa një konfiskim prej 500 kilogramësh është raportuar në janar 2022 (Kajosevic, 2022). Përveç kësaj, në Kosovë është konfiskuar një ngarkesë prej 400 kilogramësh kokainë në maj 2021, pasi ajo ishte kontrabanduar përmes portit shqiptar të Durrësit (Halili, 2021b). Ka të ngjarë, gjithashtu, që konfiskimet e kokainës të pasqyrojnë vetëm një pjesë të vogël të sasisë së përgjithshme të kokainës së trafikuar nëpër rajon. Për shembull, autoritetet malazeze dyshojnë se mbi 3 tonë kokainë janë kontrabanduar përmes portit të Barit në gjysmën e dytë të vitit 2021 (Kajosevic, 2022).

FIGURA 5
**Kokaina e konfiskuar në Ballkanin Perëndimor, 2017-2020**




Burimi: EMCDDA.

## Roli kyç në trafikun global të kokainës

Siç është theksuar më parë, rrjetet kriminale nga rajoni i Ballkanit Perëndimor janë bërë vitet e fundit lojtarë të rëndësishëm në tregun e kokainës në BE (shih pjesën "Roli dhe ndikimi i rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor në tregjet e drogave të BE-së"). Duket se ato janë të pranishme në vende kyçe të Amerikës Jugore, të tilla si Ekuador (Cela dhe Moran, 2019; Euronews, 2022; Ford, 2021), Kolumbi (Analisis Urbano, 2018; Infobae, 2021; Parkinson, 2020), Peru (El Comercio, 2018; Mandujano, 2021) dhe Brazil (Record TV, 2021), ku punojnë drejtpërdrejt me kartelet e drogës të Amerikës Jugore (shih seksionin "Një rrjet i madh kriminal shumëkombësh që importon kokainë në Evropë"). Ekzistenca e këtyre rrjeteve është zbuluar përmes disa operacioneve të suksesshme të zbatimit të ligjit që kanë ekspozuar metodat e punës së grupeve – për shembull, logjistika shumështresore, niveli i lartë i bashkëpunimit midis rrjeteve kriminale të ndryshme dhe përdorimi i teknologjisë së re, duke përfshirë komunikimet e koduara (EMCDDA dhe Europol, 2022; Europol, 2020b).

Rrjetet kriminale shqipfolëse duket se janë bërë aktorë të pavarur me lidhje të drejtpërdrejta në Amerikën Latine, ndërsa më parë ato kanë funksionuar kryesisht përmes rrjeteve kriminale italiane (McDermott e të tj., 2021; shih gjithashtu seksionin "Rrjetet shqiptare që ushtrojnë kontroll në tërë zinxhirin e furnizimit të kokainës"). Kjo nuk do të thotë se lidhjet me grupet italiane nuk vazhdojnë të ekzistojnë, por përkundrazi të dyja palët tani duket se bashkëpunojnë në pjesë të ndryshme të botës në mënyra që janë të dobishme për të dyja palët. Në përgjithësi, tani ka një sasi të konsiderueshme informacioni që sugjeron se rrjetet shqipfolëse kanë zgjeruar aktivitetet e tyre lidhur me kokainën në më shumë vende të BE-së që nga viti 2017 dhe se ato luajnë një rol më të rëndësishëm në tregun e kokainës në shumë vende, me aktivitete që përfshijnë edhe shpërndarjen në rrugë (EMCDDA dhe Europol, 2022; Europol, 2021f).

### Një rrjet i madh kriminal shumëkombësh që importon kokainë në Evropë

Një operacion ndërkombëtar i zbatimit të ligjit në 2021 ka rezultuar në kallëzime kundër 61 të dyshuarve që i përkasin një rrjeti të trafikimit të drogës të përfshirë në trafikimin e kokainës me shumicë nga Amerika Jugore në Evropë. Ky rrjet kriminal ishte i pranishëm në një numër vendesh evropiane dhe ishte i përbërë kryesisht nga kriminelë me origjinë nga Serbia, Kroacia, Mali i Zi dhe Sllovenia. Një operacion i koordinuar i zbatimit të ligjit ka mundësuar konfiskimin e 2,6 tonëve kokainë dhe 324 kilogramëve kanabis bimor, si edhe makinave luksoze dhe shumave të mëdha të parave. Hetuesit spanjollë kanë identifikuar dhe shkatërruar gjithashtu rrjedhat e tjera të rrjetit, të cilat gjenerojnë të ardhura, duke përfshirë prodhimin dhe trafikimin e kanabisit dhe shitjen e makinave luksoze. Disa anëtarë të grupit kriminal të organizuar janë akuzuar gjithashtu në Slloveni për shpërndarjen e kokainës dhe kanabisit.

Burimet: EMCDDA dhe Europol, 2022; Europol, 2021e.

Deri në një farë mase, rrjetet kriminale të angazhuara në trafikun e kokainës me anëtarë nga vendet e rajonit dhe shtetet fqinje (Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia) duket se bashkëpunojnë në mënyrë të lehtë dhe efikase me njëri-tjetrin, në bazë të një mentaliteti biznesi që u mundëson aktorëve të punojnë së bashku në rastet ku ka përfitim të ndërsjellë (EMCDDA dhe Europol, 2022). Megjithatë, ka gjithashtu një numër rastesh dhune midis rrjeteve të tilla të përfshira në tregtinë e kokainës, si brenda rajonit ashtu edhe jashtë tij (shih pjesën “Dhuna e lidhur me kokainën në BE, Ballkanin Perëndimor dhe Amerikën Jugore”). Këto grupe referohen kolektivisht nganjëherë si “Karteli i Ballkanit”. Megjithatë, emri mund të jetë çorientues dhe nuk ka prova të mjaftueshme që sugjerojnë se ekziston një kartel i Ballkanit në vetvete, por më shumë një aleancë lehtësirash midis rrjeteve të ndryshme kriminale të lidhura në mënyrë të lirshme (Djordjevic, 2021).

## Dhuna e lidhur me kokainën në BE, Ballkanin Perëndimor dhe Amerikën Jugore

Dhuna lidhur me konkurrencën për tregjet dhe rrugët e kokainës midis rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor është raportuar në BE, Ballkanin Perëndimor dhe Amerikën Jugore. Për shembull, vrasje të lidhura me trafikimin e kokainës janë raportuar në Shqipëri kohët e fundit (Oculus News, 2019; Politiko, 2022a; Tirana Post, 2021). Për më tepër, vrasjet lidhur me tregtinë e kokainës janë raportuar edhe në qytete të ndryshme të BE-së (shih gjithashtu pjesën Roli dhe ndikimi i rrjeteve kriminale të Ballkanit Perëndimor në tregjet e drogave të BE-së), si edhe në vendet dhe qytetet fqinje, të tilla si Kievi i Ukrainës (Replianchuk dhe Loginova, 2020).

Dhuna e lidhur me rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor është raportuar gjithashtu në Amerikën Jugore. Megjithatë, duket se atje këto rrjete kanë qenë më shpesh viktimat e

### Rrjetet shqiptare që ushtrojnë kontroll në gjithë zinxhirin e furnizimit të kokainës

Historikisht, grupet e përfshira në importin e sasive të mëdha të kokainës në BE kishin një tendencë për të punuar në mënyrë të ndarë nga bandat përgjegjëse për shpërndarjen e drogave nëpër tregjet lokale të drogës. Kohët e fundit, janë vërejtur raste të rrjeteve kriminale shqipfolëse, të cilat duket se e braktisin këtë model dhe kanë marrë kontrollin e importit dhe shpërndarjes së drogës. Për shembull, një rrjet dihet se ka përdorur teknologji të sofistikuara të komunikimit të koduar për të mbajtur kontakt me kreun e organizatës, me bazë në Ekuador, i cili ka negociuar drejtpërsëdrejti me kartelet e drogës të Amerikës Jugore, duke rënë dakord mbi dërgesa të mëdha kokaine të dërguara në portet kryesore të Evropës. Bashkëvepruesit me seli në Itali, Holandë dhe Shqipëri e kanë lehtësuar këtë proces dhe ishin gjithashtu përgjegjës për shpërndarjen te konsumatorët. Kokaina është kontrabanduar përtej kufijve evropianë, e futur në ndarjet e fshehura të makinave dhe kriminelët i kanë pastruar të ardhurat, duke përdorur një sistem alternativ të nëndheshëm me origjinë kineze, të njohur si sistemi fei ch’ien, i cili është i ngjashëm me sistemin e transferimit të parave "Havala".

Burimet: EMCDAA dhe Europol, 2022; Europol, 2020b.

dhunës sesa autorët e saj. Ky ka qenë rasti, për shembull, në Ekuador, ku anëtarët e dyshuar të rrjeteve shqipfolëse kanë rënë viktima të vrasjeve në stil mafioz dhe mendohet se ata janë të lidhur me aktivitete kriminale që kanë të bëjnë me portin Guayaquil (Cela dhe Moran, 2019; EMCDDA dhe Europol, 2022; Euronews, 2022; Ford, 2021). Vrasje të mëtejshme kanë ndodhur në Brazil (Record TV, 2021) dhe Kolumbi (Analisis Urbano, 2018; EMCDDA dhe Europol, 2022; Parkinson, 2020).

Në përgjithësi, duket se rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor e përdorin dhunën në një mënyrë strategjike dhe të kontrolluar, kryesisht për të ruajtur besueshmërinë e tyre si një kërcënim, gjë që raportohet të jetë një nga tiparet kryesore të modelit të tyre të biznesit në tregtimin e kokainës (EMCDDA dhe Europol, 2022; Kemp, 2020b; Townsend, 2019).

## Çmimet e kokainës

Çmimi mesatar i kokainës me pakicë në rajon midis viteve 2018 dhe 2020 është vlerësuar në afërsisht 76 EUR për gram. Në Bosnjë dhe Hercegovinë është raportuar çmimi mesatar më i ulët (67 EUR/g), ndërsa çmimi më i lartë është raportuar në Serbi (86 EUR/g). Kokaina mund të blihet në doza më të vogla se 1 gram në disa vende. Në Shqipëri, për shembull, duket se sasia më e shitur mesatarisht varion midis 0,25 dhe 0,30 gramësh, për 25 deri në 30 EUR për gram. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi dhe Serbi, është raportuar se gjysmë gram kokainë mund të blihet për 40 deri në 50 EUR. Përveç kësaj, në Malin Zi mund të blihet një "vizë" për afërsisht 5 deri në 10 EUR, dhe duket se çmimi mund të zvogëlohet deri në 70 EUR nëse blihen së paku 5 gramë. Në Kosovë, njësia më e popullarizuar është 0,6 gramë, e cila shitet për afërsisht 55 deri 60 EUR. Produkte të tjera të kokainës duket se janë gjithashtu të disponueshme në rajon, të tilla si kokaina krak, e cila raportohet se mund të gjendet në Shqipëri në sasi që variojnë nga një e dhjeta deri në një të pestën e një grami me një çmim mesatar midis 20 EUR dhe 25 EUR (Kemp e të tj., 2021).

Në bazë të informacionit në dispozicion, çmimi mesatar i kokainës me shumicë në rajon midis viteve 2018 dhe 2020 është vlerësuar në 39 000 EUR për kilogram. Në Shqipëri është raportuar çmimi mesatar më i ulët (30 000 EUR/kg) ndërsa në Serbi është raportuar çmimi më i lartë (45 000 EUR/kg). Në nivel të shitjes me shumicë, kokaina shitet zakonisht me kilogram. Duke marrë parasysh se rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor janë tani aktive përgjatë të gjithë zinxhirit të furnizimit me kokainë, konsiderohet se ato janë në gjendje të negociojnë çmimet për kilogram drejtpërsëdrejti në burim, në vendet e Amerikës Jugore që prodhojnë droga. Kjo tregon se rrjetet kriminale janë ndoshta në gjendje të rrisin marzhet e tyre të fitimit duke nxjerrë vlerë nga tërë zinxhiri i furnizimit, në vend që të ndajnë përgjegjësinë për pjesë të caktuara të operacionit me rrjete kriminale të tjera. Për shembull, një kilogram kokainë që arrin në Shqipëri me një çmim midis 20 000 dhe 25 000 EUR për kilogram mund të përzihet dhe të rishitet në Evropën perëndimore për 35 000 deri në 42 000 EUR për kilogram – pothuajse tetë herë më shumë se çmimi fillestar i raportuar në Amerikën Latine (Kemp e të tj., 2021).

## Heroina dhe opioidet e tjera: përdorimi dhe furnizimi

Heroina mbetet opioidi i paligjshëm më i rëndësishëm në rajon dhe është gjithashtu një nga drogat e injektuara më të zakonshme. Ajo kontribuon ndjeshëm në dëmet e përgjithshme lidhur me drogat dhe mbetet shkaku kryesor që i motivon njerëzit për të kërkuar trajtim për problemet lidhur me përdorimin e drogës.

Trendet në konfiskimet e raportuara të heroinës kanë rënë pak në vitin 2020, megjithëse kjo ka ndodhur pas një rritjeje në vitin 2019 dhe tabloja afatmesme duket relativisht e qëndrueshme. Shumica e heroinës së konfiskuar në rajon mendohet se është e destinuar për në BE, me rrugë tokësore ose detare. Nuk janë shënuar ndryshime të rëndësishme në metodat e trafikimit të heroinës në vitet e fundit. Megjithatë, siç është diskutuar më parë, ka një shqetësim të ri se tani mund të ekzistojnë lidhje midis trafikimit të kanabisit dhe heroinës. Kjo temë kërkon hetime dhe ndjekje të mëtejshme.

### Opioidet janë të lidhura me shumicën e dëmeve

Heroina dhe opioidet e tjera vazhdojnë të jenë një nga shkaqet kryesore të dëmeve të lidhura me drogat në rajon, ndërsa problemet me përdorimin e opioideve janë arsyeja kryesore që i motivon njerëzit për t'iu nënshtruar trajtimit për droga në vendet e Ballkanit Perëndimor. Mbidozat e heroinës ose opioideve të tjera janë raportuar në të katërta shtetet për të cilat ka të dhëna lidhur me vdekshmërinë.

Informacioni në dispozicion sugjeron se heroina është opioidi i paligjshëm më i rëndësishëm në gjithë rajonin, me përjashtim të Kosovës, ku shumica e njerëzve që i nënshtrohen trajtimit raportojnë përdorimin e metadonit dhe Maqedonisë së Veriut ku metadoni konsiderohet të jetë droga e injektuar më e zakonshme dhe është e lidhur gjithashtu me shumicën e mbidozave fatale të raportuara të drogës, shpesh në kombinim me benzodiazepinat. Heroina zakonisht injektohet, nganjëherë së bashku me substanca të tjera duke përfshirë kokainën (EMCDDA, 2021b)

Problemet e lidhura me heroinën mund të jenë më akute te pakica të caktuara, për shembull, komuniteti rom duket të preket gjithnjë e më shumë nga përdorimi i opioideve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi (EMCDDA, 2021b).

Buprenorfina është gjithashtu në dispozicion në tregun e drogave në disa vende. Në Serbi, rreth 10% e klientëve që marrin trajtim për opioide raportojnë se buprenorfina është nga drogat më të rëndësishme; ndërsa në Malin e Zi ekspertët kanë ngritur shqetësime lidhur me devijimin e mundshëm të buprenorfinës mjekësore.

Vërejtjet e ekspertëve sugjerojnë se përdorimi i përgjithshëm i heroinës në rajon mund të jetë në rënie. Megjithatë, nuk është e qartë nëse kjo sinjalizon një rënie në nivelet e përgjithshme të modeleve kronike lidhur me përdorimin problematik të drogës ose tregon se heroina thjesht po zëvendësohet në treg nga opioide sintetike ose droga të tjera.

### Konfiskimet e heroinës relativisht të qëndrueshme gjatë periudhës 2017-2020

Konfiskimet e heroinës dhe morfinës duket se kanë rënë pak në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2020 (UNODC, 2022). Megjithatë, në përgjithësi, tabloja afatmesme në rajon dukej relativisht e qëndrueshme midis 2017 dhe 2020, duke shënuar një kulm në vitin 2019 për shkak të rritjes së konfiskimeve në Serbi (shih Figurën 6). Megjithëse vlerat totale kumulative nuk janë akoma në dispozicion, kohët e fundit janë bërë disa konfiskime të rëndësishme. Për shembull, 67,5 kilogramë heroinë janë konfiskuar në maj 2022 në Kosovë (RTKLIVE, 2022b) dhe 45,5 kilogramë janë konfiskuar në tetor 2021 në Shqipëri (Oculus News, 2021). Megjithatë, analiza paraprake e të dhënave rajonale në dispozicion për 2021 dhe 2022 nuk tregon asnjë ndryshim të rëndësishëm.

FIGURA 6
**Heroina e konfiskuar në Ballkanin Perëndimor, 2017-2020**




Burimi: EMCDDA.

## Heroina mund të prodhohet nga morfina në rajon

Heroina afgane kontrabandohet kryesisht nëpër Ballkanin Perëndimor në rrugën për në BE, megjithëse një pjesë e këtyre dërgesave mbetet në rajon për konsum të brendshëm. Ka gjithashtu tregues se hapi i fundit i procesit të prodhimit të heroinës, prodhimi i heroinës nga morfina, mund të kryhet në Ballkanin Perëndimor. Për shembull, një objekt për prodhimin e heroinës raportohet se është zbuluar në Shqipëri në vitin 2018 (ABC News, 2018). Prodhimi i brendshëm i heroinës nga opiatet e importuara mund të gjenerojë fitime shumë më të mëdha sesa rishitja e heroinës së importuar, por ky proces kërkon njohuri të specializuara, pajisje dhe qasje në kimikatet prekursore.

## Heroina: trafikohet me rrugë tokësore dhe detare

Rruga tokësore e Ballkanit, nga Afganistani nëpër Iran, Turqi dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, është rruga më e shkurtër dhe më e drejtpërdrejtë për të sjellë heroinën në tregjet evropiane të konsumit dhe për këtë arsye ajo është rruga më e zakonshme për trafikimin e heroinës në BE (EMCDDA dhe Europol, 2019). Si degët jugore ashtu edhe ato qendrore të rrugës ballkanike kalojnë nëpër Ballkanin Perëndimor (Figurën 7).

Heroina mund të hyjë në rajon nga Bullgaria nëpërmjet Serbisë ose Maqedonisë e Veriut. Nga aty transportohet më tej në Shqipëri, Kosovë, Malin e Zi dhe Bosnjë dhe

FIGURA 7
**Degët e rrugës ballkanike**



### Konfiskohen 67,5 kilogramë heroinë në Kosovë

Në maj 2022, autoritetet e Kosovës kanë konfiskuar një sasi të konsiderueshme heroine, 67,5 kilogramë, duke arrestuar 14 të dyshuar gjatë këtij operacioni. Sipas informacionit të ofruar në EMCDDA, heroina është përpunuar në dy laboratorë të improvizuar në Kosovë nga të dyshuarit turq, të cilët punonin së bashku me një rrjet kriminal lokal.

Burimet: RTKLIVE, 2022b.

Hercegovinë, por dërgesat mund të hyjnë në rajon edhe nga Greqia (Byroja e Koordinimit Operacional, 2021; shih gjithashtu seksionin Konfiskohen 67,5 kilogramë heroinë në Kosovë). Dërgesat e heroinës mund të hyjnë pastaj në BE me rrugë tokësore, nëpër Kroaci dhe Hungari ose me rrugë detare nga Shqipëria në Itali (shih gjithashtu Figurën 1). Ka disa shembuj për këtë kohët e fundit. Në tetor 2021, 45,5 kilogramë heroinë janë konfiskuar në portin e Durrësit, të cilët ishin ngarkuar në një kamion me destinacion Italinë (Oculus News, 2021), ndërsa në qershor 2022, 24 kilogramë heroinë janë konfiskuar në Itali pas mbërritjes me traget nga i njëjti port (Kote, 2022a). Siç është theksuar më parë, kanabisi bimor mund të transferohet nga Ballkani Perëndimor në Turqi në këmbim të heroinës, duke krijuar mundësi të reja për rrjetet kriminale të Ballkanit Perëndimor të përfshira në tregtinë e drogës (Mejdini dhe Amerhauser, 2019; Sinoruka, 2022; Departamenti i Shtetit i SHBA-së, 2022).

Prekursori kryesor i heroinës, anhidridi acetik, mund të kontrabandohet gjithashtu nga BE në zonat e prodhimit të heroinës nëpër Ballkanin Perëndimor, me disa raste të regjistruara në të kaluarën. Në vitin 2017, për shembull, dy dërgesa të veçanta – prej 3720 dhe 5000 kilogramësh – janë konfiskuar, pasi është bërë një përpjekje për t'i kontrabanduar përmes kufirit nga Serbia në Bullgari (Zyra e Prokurorit të Bullgarisë, 2017; Xinhua, 2017).

## Çmimet e heroinës

Çmimi mesatar i heroinës me pakicë në rajon midis viteve 2018 dhe 2020 raportohet se ishte 20 EUR për gram, me çmimin mesatar më të ulët në Maqedoninë e Veriut (16,5 EUR) dhe çmimin më të lartë në Serbi (21,5 EUR). Në Kosovë, heroina shitet në sasi të vogla prej 0,25 gramë për 5 EUR. Praktika të ngjashme të shitjes me pakicë janë vërejtur në Serbi, ku 0,2 gram (një "shot") shitet për afërsisht 7-8

EUR. Në Malin e Zi, njësia më e zakonshme e shitjes është gjysmë grami, e cila shitet për 5 deri në 10 EUR, në varësi të cilësisë. Intervistat e kryera me përdoruesit e heroinës në një OJQ për zvogëlimin e dëmit në Maqedoninë e Veriut sugjerojnë se blerja e substancës në sasi të vogla dhe konsumimi i saj i menjëhershëm është më i zakonshëm sesa blerja e sasive më të mëdha, për shkak të rrezikut të kapjes nga policia gjatë bartjes së drogave të papërdorura.

Çmimi mesatar i heroinës me shumicë në rajon midis viteve 2018 dhe 2020 ishte 17 000 EUR për kilogram, me çmimin mesatar më të ulët në Malin e Zi (1 .000 EUR/kg) dhe çmimin më të lartë në Serbi (19 000 EUR/kg). Në tërë rajonin, çmimet e shitjes së heroinës me shumicë mund të arrijnë deri në 2000 EUR për kilogram, duke marrë parasysh që çmimi ka tendencë për t'u rritur me kalimin e çdo kufiri (Kemp e të tj., 2021).

# Drogat sintetike: përdorimi, prodhimi dhe furnizimi

Megjithëse drogat sintetike përfshijnë një gamë të gjerë substancash, informacioni në dispozicion në rajon lidhet më së shumti me amfetaminat (amfetaminat dhe metamfetaminat) dhe MDMA. Duket se amfetaminat përdoren më pak sesa droga të tjera në shumicën e vendeve në rajon, por informacioni në dispozicion sugjeron nivele të ngjashme të përhapjes në shumë vende të BE-së. Nivelet e përhapjes së përdorimit të MDMA-së janë të ngjashme me ato të raportuara për amfetaminat, por më të ulëta sesa në BE. Mendimi i ekspertëve sugjeron se MDMA përdoret kryesisht në jetën e natës ose në mjedise rekreative të tjera të ngjashme.

Tregjet lokale të drogave sintetike duket të jenë mjaft të ndryshueshme dhe dinamike. Kërkesa për drogat sintetike mbulohet kryesisht nga prodhimi jashtë rajonit, megjithëse prodhimi lokal i drogave sintetike është vërejtur herë pas here.

## Përdorimi i stimuluesve të ndryshëm nga kokaina

Në bazë të të dhënave në dispozicion, përdorimi i stimuluesve të ndryshëm nga kokaina duket të jetë relativisht i pazakonshëm në rajon (shih seksionin Përdorimi i substancave psikoaktive të reja). Të dhënat nga sondazhet në shkolla raportojnë nivele përdorimi që janë të barabarta ose edhe më të larta sesa mesatarja evropiane ndër adoleshentët. Megjithatë, gabimi i arsyeshëm në matje do të thotë se çdo ndryshim duhet të interpretohet me kujdes. Për shembull, në vitin 2019, përhapja e përdorimit të amfetaminës gjatë jetës te njerëzit në moshën 15 deri në 16 vjeç ishte 2% si në Malin e Zi ashtu edhe në Serbi, ndërsa shifra mesatare në të gjitha vendet ESPAD ishte 1,3% (ESPAD, 2021). Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i metamfetaminave nga nxënësit e shkollave të mesme ka tejkaluar mesataren evropiane në Shqipëri në vitin 2015 dhe në Malin e Zi dhe Serbi në vitin 2019, ndërsa përdorimi i MDMA-së ishte gjithashtu relativisht i lartë në Shqipëri në vitin 2015 dhe në Malin e Zi në vitin 2019. Ndër të rinjtë, përveç përdorimit të MDMA-së në Malin e Zi dhe të amfetaminave në Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, të dhënat në dispozicion sugjerojnë se normat e përhapjes së përdorimit të stimuluesve sintetikë në rajon janë më të ulëta sesa ato që raportohen zakonisht në BE.

Sipas vërejtjeve të praktikuesve në terren, përdorimi i MDMA-së rritet në verë me fluksin e turistëve të huaj dhe emigrantëve që kthehen në atdhe për pushime.

### Përdorimi i substancave psikoaktive të reja

Të dhënat mbi përdorimin e substancave psikoaktive të reja (SPR) janë jashtëzakonisht të kufizuara. Disa tregues të pranisë së tyre në tregun rajonal të drogave mund të merren nga EWSD në vitin 2021, ku midis 9% e të anketuarve në Malin e Zi dhe 23% në Maqedoninë e Veriut, kanë raportuar përdorimin e SPR-ve gjatë vitit të fundit. Megjithëse këto rezultate tregojnë praninë e SPR-ve në tregun rajonal të drogave, ato nuk mund të përgjithësohen për asnjë popullsi më të madhe. Në sondazhin ESPAD 2019, nga 1% e studentëve në Maqedoninë e Veriut deri në 2,6% në Malin e Zi kanë raportuar përdorimin e ndonjë SPR. Raportet cilësore nga terreni sugjerojnë përdorimin sporadik të fentanilit nga njerëzit që injektojnë droga, siç është vërejtur në Malin e Zi. Kanabinoidët sintetikë duket të jenë popullorë në Serbi. Megjithatë, të dhënat sasiore dhe studimet mjeko-ligjore në dispozicion janë të pamjaftueshme në përgjithësi për të bërë komente të informuara mbi tendencat lidhur me disponueshmërinë dhe përdorimin e SPR-ve në rajon.

## Konfiskimet e drogave sintetike

Amfetaminat janë droga sintetike më e konfiskuar në rajon midis 2017 dhe 2020, e ndjekur nga MDMA (ekstaz) (shih Figurën 8) ([7]). Konfiskimet e amfetaminave në këtë periudhë janë kryer kryesisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Maqedonia e Veriut ka konfiskuar pothuajse të gjitha amfetaminat e raportuara gjatë kësaj periudhe në vitin 2017, kur është shkatërruar një laborator për prodhimin e paligjshëm të amfetaminave (shih seksionin "Shkatërrimi i objekteve për prodhimin e drogave sintetike në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi"). Nga të gjitha vendet në rajon, Serbia ka raportuar më së shumti konfiskime të MDMA-së (ekstazit) midis 2017 dhe 2020, pasuar nga Bosnja dhe Hercegovina.

Sasi shumë të vogla të drogave sintetike janë konfiskuar gjithashtu në Shqipëri, Kosovë dhe Malin e Zi, me më pak se 6 kilogramë amfetaminë, metamfetaminë dhe MDMA (ekstaz) të konfiskuar midis 2017 dhe 2020.

([7]) Konfiskimet e drogave sintetike janë raportuar si në kilogramë ashtu edhe në tableta. Për të mundësuar krahasueshmërinë, sasitë e raportuara në tableta janë konvertuar në kilogramë duke përdorur një vlerë prej 250 mg për tabletë.

FIGURA 8
**Amfetaminat dhe MDMA të konfiskuara në Ballkanin Perëndimor, 2017-2020**




Burimi: EMCDDA.

## Prodhimi i drogave sintetike duket të jetë i pazakonshëm në rajon

Në këtë moment, Ballkani Perëndimor nuk duket të luajë një rol të madh në prodhimin e drogave sintetike. Ka pasur raportime për një numër të vogël objektesh për prodhimin e amfetaminave, të cilat janë zbuluar dhe shkatërruar, për shembull në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut, 2017) dhe së fundmi në Bosnjë dhe Hercegovinë (Klix, 2022). Përveç kësaj, një objekt për prodhimin e MDMA-së (ekstazit) është shkatërruar në Serbi, me sa duket, në vitin 2017, megjithëse ka pak detaje në dispozicion (B92, 2017; RTS, 2017).

## Transporti i drogave sintetike dhe prekursorëve të tyre

Tani për tani, rrjetet kriminale e Ballkanit Perëndimor duket të jenë të përfshira më pak në trafikimin e drogave sintetike në krahasim me substanca të tjera. Megjithëse besohet se një numër rrjetesh janë të përfshira në disa trafikime relativisht të vogla në rajon të drogave sintetike të prodhuara në BE (Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë, 2020a), informacioni në dispozicion në këtë moment sugjeron se angazhimi i rrjeteve kriminale në këtë treg është i kufizuar. Duke pasur parasysh natyrën shumë dinamike të tregut të drogave, vështirësitë për të zbuluar objektet e paligjshme të prodhimit dhe fitimet që mund të nxirren nga prodhimi i drogave sintetike, kjo fushë kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe hetime të mëtejshme.

### Shkatërrimi i objekteve për prodhimin e drogave sintetike në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi

